



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Korrik 2021/ Nr. 7



Ministri Peleshi takon homologen Injac
Shqipëri - Mali i Zi: Do të
rritet bashkëpunimi në fushën
e Sigurisë dhe Mbrojtjes



Vizita në Kosovë
Gjeneralmajor Begaj: Do të
rrisim aftësitë dhe kapacitetet në
fushën e mbrojtjes të dy vendeve



Gjeneralmaiore Manushaqe Shehu
E para grua ushtarake
me gradën më të lartë në
Forcat e Armatosura



MINISTRI PELESHI VIZITË ZYRTARE NË LETONI
Do të vijojmë kontributin në
misionin e NATO-s në veri të Europës

Përmbajtja

Numri 7

VIZITA NË ESTONI

- 6** Ushtarakët do trajnohen në Qendrën e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s

VIZITA NË KOSOVË

- 11** Do të rrisim aftësitë dhe kapacitetet në fushën mbrojtjes të dy vendeve

SARAJEVË, BOSNJË-HERCEGOVINË

- 14** Gjeneralmajor Begaj në Konferencën e 14-të të Shefave të Shtabit të Vendeve Ballkanike

QKMBMMFA

- 28** Koncert festiv me rastin e 1 Qershorit

BOTIME

- 36** Gjeopolitika dhe fuqia ushtarake shqiptare në penën e një koloneli

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



4 VIZITË ZYRTARE NË LETONI

Ministri Peleshi: Do të vijojmë kontributin në misionin e NATO-s në veri të Europës

Pas vizitës zyrtare në Estoni, ministri i Mbrojtjes zoti Niko Peleshi me ftesë të homologut të tij zotit Artis Pabriks, vijoi vizitën më 4 qershor në Letoni. Dy delegacionet zhvilluan...



9 TAKIMI

Shqipëri - Mali i Zi: Do të rritet bashkëpunimi në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, ka dhënë mesazhin e saj në nisjen e stërvitjes "Defender Europe 21", në Portin e Durrësit. Teksa e ka cilësuar...



13 GJENERALMAJORE SHEHU

E para grua ushtarake me gradën më të lartë në Forcat e Armatosura

Në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ditën e martë, më 22 qershor 2021, ceremonia e gradimit të zëvendëshefes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura...



47 SAMITI I NATO-S MË 14 QERSHOR 2021

Stoltenberg: NATO po hap një kapitull të ri

Duke mbërritur në Samitin e NATO-s më 14 qershor 2021, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se takimi do të ishte një...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 7/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elek-
tronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





MINISTRI PELESHI VIZITË ZYRTARE NË LETONI

Do të vijojmë kontributin në misionin e NATO-s në veri të Europës

Pas vizitës zyrtare në Estoni, ministri i Mbrojtjes zoti Niko Peleshi me ftesë të homologut të tij zotit Artis Pabriks, vijoi vizitën më 4

qershor në Letoni. Dy delegacionet zhvilluan një takim miqësor, në të cilin patën mundësinë të ndanin mendimet dhe idetë e tyre për të zhvilluar dhe intensifikuar

më tej bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes, ku interes të veçantë përbëjnë fushat e arsimit ushtarak dhe komunikimit strategjik.

Zoti Peleshi shprehu mirën-



Ministrat Peleshi dhe Pabriks shprehën gatishmërinë për të mbështetur vendimet dhe angazhimet që priten të konfirmohen në Samitin e NATO-s në Bruksel



johjen e tij për mbështetjen e vijueshme që Letonia i ka dhënë Shqipërisë jo vetëm gjatë procesit të anëtarësimit në NATO, por edhe në përpjekjet që vendi ynë po bën

për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian.

Të dy ministrat vlerësuan kontributet respektive në angazhimet në kuadër të Aleancës si edhe

shprehën gatishmërinë për të mbështetur vendimet dhe angazhimet që priten të konfirmohen në Samitin e NATO-s në Bruksel.

Ministri i Mbrojtjes rikonfirmoi vijimin e prezencës me një togë EOD në Camp Adazi, në kuadër të misionit të NATO-s "enhanced Forward Presence". Ai falënderoi ministrin Pabriks për të gjithë mbështetjen që pala letoneze i siguron kontingjentit shqiptar, në mënyrë të veçantë gjatë ngjarjes tragjike të ndodhur dy vite më parë, ku humbën jetën dy ushtarakë shqiptarë.

Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes, zoti Peleshi udhëtoi për në Camp Adazi, ku u takua me zyrtarët ushtarakë letonezë dhe drejtuesit kanadezë të grup-batalionit. Në takimin me kontingjentin shqiptar, ministri përgëzoi personelin e FARSH në misionin "enhanced Forward Presence" për kontributin në mbrojtjen kolektive, profesionalizmin e tyre si edhe për vlerësimin e lartë që ata kanë tek kolegët e vendeve partnere. Ministri i Mbrojtjes vendosi një kurorë me lule në memorialin e dëshmorëve të atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetar Zarife Hasanaj, të cilët ranë në krye të detyrës dy vjet më parë.

"Skuadra jonë EOD na përfaqëson me profesionalizmin më të lartë atje. Fjalët e mira për ta nga ministri letonez Pabriks dhe komandanti kanadez i grup-batalionit na bëjnë krenar të gjithëve. Një nderim i veçantë për dëshmorët e rënë në Letoni major Klodian Tanushi dhe nëntetar Zarife Hasanaj", shkruan ministri Peleshi. Më 6 maj 2019 në kampin e NATO-s në Letoni gjatë një seance stërvitore shpërtheu një mine, ku si pasojë humbi jetën në vend nëntetarja Zarife Hasanaj, ndërsa Klodian Tanushi u plagos rëndë dhe u nda nga jeta disa ditë më vonë në spital, pa u rezistuar dot plagëve të marra nga shpërthimi i eksplozivit. Dy ushtarakët janë nderuar me titullin "Dëshmor i Atdheut".

Ushtarakët do trajnohen në Qendrën e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s

Ministrat Peleshi dhe Kalle Laanet vlerësuan kontributet respektive dhe pjesëmarrjen ndër vite, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, në datat 2-3 qershor, zhvilloi një vizitë zyrtare në Estoni, ku gjatë takimit me homologun Kalle Laanet, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e jashtëzakonshme diplomatike të Estonisë për Shqipërinë dhe faktorin shqiptar në rajon.

Peleshi vlerësoi Estoninë si një nga vendet që shprehet qartë për domosdoshmërinë e integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian duke e konsideruar procesin e hapjes së negociatave thelbësor për paqen dhe sigurinë në rajon.

Të dy ministrat e Mbrojtjes vlerësuan kontributet respektive dhe pjesëmarrjen ndër vite, me një numër të konsiderueshëm trupash, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

Ata rikonfirmuan qëndrimin se do të vijojnë të jenë mbështetës të çdo vendimi që Aleanca do të marrë në lidhje me Afganistanin, tashmë që misioni Rolute Support përfundoi si edhe të çdo vendimi tjetër që pritet të merret në Samitin e Brukselit, me fokus në agjendën e NATO 2030. Ministri i Mbrojtjes Peleshi theksoi angazhimin për intensifikimin e marrëdhënieve bi-



laterale në fushën e mbrojtjes me Estoninë. Në mënyrë të veçantë biseda u përqendrua në mundësitë e mbështetjes me kurse dhe trajnime të personelit shqiptar në Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Cyber Defense, (NATO Center of Excellence for Cyber Defense, Tallinn), një sfidë e re kjo për Shqipërinë. Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes së Estonisë delegacioni shqiptar zhvilloi një vizitë në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes, në Tartu të Estonisë, ku u trajtuan gjerësisht mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës me Akademinë e Forcave të Armatosura në Tiranë. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shoqërohej nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade Albert Mullai.



Çfarë është Qendra e Ekselencës e Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s?

Qendra e Ekselencës së NATO-s, për Cyber Defense, është e vendosur në Talin, Estoni. Qendra u krijua në 14 maj 2008, ajo mori akreditim të plotë nga NATO dhe arriti statusin e Organizatës Ushtarake Ndërkombëtare në 28 Tetor 2008. Qendra e Ekselencës së NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike është një Organizatë Ushtarake Ndërkombëtare me një mision për të rritur aftësinë, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis NATO-s, kombeve të saj anëtare dhe partnerëve në mbrojtjen kibernetike me anë të edukimit, kërkimit dhe zhvillimit, mësimëve të marra dhe konsultimit.

Në vitin 2003, përpara hyrjes zyrtare në NATO, Estonia propozoi krijimin e një Qendre të Ekselencës për mbrojtjen kibernetike. Takimi i nivelit të lartë të Rigës në vitin 2006 renditi sulmet e mundshme kibernetike midis kërcënimeve asimetrike ndaj sigurisë së përbashkët dhe pranoi nevojën

për programe për të mbrojtur sistemet e informacionit për një periudhë afatgjatë. Sulmet kibernetike ndaj Estonisë në 2007 nxorën në pah për herë të parë cenueshmërinë e mundshme të cilido vend të NATO-s, institucioneve dhe shoqërive të tyre, madje edhe vetë NA-

TO-s për përçarjen ose depërtimin e sistemeve të tyre të informacionit dhe komunikimit. Në janar 2008, NATO miratoi politikën mbi mbrojtjen kibernetike çka i hapi rrugë miratimit të Estonisë për ngritjen e Qendrës së Ekselencës për Mbrojtje Kibernetike në Talin. Komunikata e Samitit të NATO-s në Bukuresht në muajin prill 2008, njoftoi gatishmërinë e NATO-s për "të siguruar një aftësi për të ndihmuar kombet aleate, me kërkesë, për t'iu kundërvënë një sulmi kibernetik".

Kombet themelues të Qendrës së Ekselencës për Mbrojtjen Kibernetike të NATO-s (NATO Center of Excellence for Cyber Defense, Tallinn), ishin Estonia, Gjermania, Italia, Letonia, Lituania, Sllovakia dhe Spanja. Më pas, gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2019 u bashkuan shumë vende të tjera duke e çuar numrin e tyre në 25. Konkretisht ato janë: Estonia, Gjermania, Italia, Letonia, Lituania, Sllovakia, Spanja, Hungaria, Polonia, Shtetet e Bashkuara, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Republika Çeke, Austria, Finlanda, Greqia, Turqia, Bullgaria, Danimarka, Norvegjia, Rumania, Belgjika, Suedia dhe Kanadaja. Katër anëtarë të rinj, iu shtuan grupit në qershor 2019 dhe ato ishin: Bullgaria, Danimarka, Norvegjia dhe Rumania duke e çuar numrin e tyre në 25. Anëtarësimi është i hapur për të gjitha vendet e NATO-s, por edhe partnere. Gjithashtu mund të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me kombe jo-të NATO-s, universitete, institucione kërkimore dhe biznese si Pjesëmarrës Kontribues.



Gjatë vizitës në Estoni, Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i shoqëruar nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade Albert Mullai, ka zhvilluar në 3 qershor 2021, një vizitë në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes (BALTDEFCOL).

Gjatë vizitës, Gjeneral Brigade Ilmar Tamm, Komandanti i Kolegjit Baltik të Mbrojtjes, me praninë e anëtarëve të Grupit të Menaxhimit të Kolegjit dhe një informim dhe prezantoi Kolegjin si organizatë rajonale për Arsimin Ushtarak Profesional (PME) dhe theksoi rolin e Kolegjit në sistemin e edukimit ushtarak. Paraqitja përfshiu një përmbledhje të strukturës së arsimimit, duke përfshirë kurse të certifikuara nga NATO dhe ESDC, dhe përparësitë e kërkimit. "Që nga themelimi, shtatë studentë shqiptarë kanë marrë pjesë në kurset tona kryesore dhe që nga viti 2016 flamuri shqiptar përfaqësohet brenda anëtarëve të familjes BALTDEFCOL", -tha gjeneral brigade Ilmar Tamm. Shkurtimeisht u pasua nga shkëmbimi i përvojave në lidhje me arsimin ushtarak, i cili lidhet me zhvillimin e vazhdueshëm të Arsimit Ushtarak Profesional (PME) në Shqipëri. Fushat e interesit mbuluan të gjitha nivelet e arsimit ush-

Akademia e Forcave të Armatosura do bashkëpunojë me Kolegjin Baltik të Mbrojtjes



tarak me fokus specifik: sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit ushtarak. Të dy drejtuesit e strukturave ranë dakord për të zgjeruar bashkëpunimin në të ardhmen bazuar në identifikimin e interesave dhe mundësive të ndërsjella në lidhje me arsimin dhe kërkimin shkencor ushtarak. Gjeneral

Brigade Ilmar Tamm, ka ftuar ushtarakët shqiptarë në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes për të ndjekur aktivitetet specifike arsimore, si pjesë e shkëmbimit të përvojave. Vizita përfundoi me një shprehje të ndërsjellë të qëllimit për të vazhduar dhe intensifikuar bashkëpunimin midis dy institucioneve ushtarake.

Ministri Peleshi i jep "Medaljen e Mirënjohjes"

Kontributi i kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach për forcimin e marrëdhënieve të FA-së shqiptare me ushtritë e tjera aleate, bëri që ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi t'i akordonte atij "Medaljen e Mirënjohjes". Gjatë vizitës së tij në vendin tonë, që përkon edhe me përfundimin e mandatit të tij në krye të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach u prit më 7 qershor 2021, nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ministri Peleshi e cilësoi si shumë të veçantë vizitën e gjeneralit britanik, i cili mori besimin për të kryesuar Komitetin Ushtarak të NATO-s pikërisht në Tiranë, në shtator të vitit 2017.

Zoti Peleshi e përgëzoi Air Chief

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach mbyll mandatin

Marshal Sir Stuart Peach për lidhshërinë dhe profesionalizmin me të cilin ai drejtoi për gati katër vite këtë forum të rëndësishëm të Aleancës dhe për objektivat e arritura.

Air Chief Marshal Sir Stuart

Peach do t'i dorëzojë detyrën e kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralit Rob Bauer, deri tani shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Holandës.



Air Chief Marshal Sir Stuart Peach do t'i dorëzojë detyrën e kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralit Rob Bauer, deri tani shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Holandës

Shqipëri - Mali i Zi: Do të rritet bashkëpunimi në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Peleshi: Mbështetja e “Politikës së dyerve të hapura” të NATO-s, është i vetmi mjet i cili realizon qëllimin e përbashkët për një rajon sa më të sigurt”

Samiti i NATO-s u zhvillua më 14 Qershor 2021, në Bruksel, ku morën pjesë krerët më të lartë të botës si Presidenti i Amerikës, Joe Biden, Kancelarja gjermane Angela Merkel, Presidenti i Francës Emmanuel Macron, Kryeministri i Britanisë Boris Johnson, kryeministri i Turqisë, Taip Erdogan, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ushtarakë të lartë, etj.

Delegacioni shqiptar kryesohej nga kryeministri Edi Rama, shoqëruar nga Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi gjatë pjesëmarrjes së tij në Samitin e NATO-s në Bruksel, pati mundësinë të zhvillojë një takim dy palësh me ministren e Mbrojtjes të Malit të Zi, Znj. Olivera Injac. Gjatë këtij takimi, dy ministrat e mbrojtjes diskutuan mbi bashkëpunimin dy palësh në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke vënë theksin se ky bashkëpunim do të vijojë të jetë një nga prioritetet kryesore dhe do të intensifikohet më shumë në të ardhmen.

Z. Peleshi u shpreh se politika e jashtme e Shqipërisë është e orientuar dhe thellësisht e angazhuar në promovimin e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit dhe integritetit të rajonit tonë. Shqipëria është dhe do të vijojë të jetë një partner i besueshëm si edhe do të vazhdojë kontributin e saj në forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe sigurimin e

paqes në rajon dhe më gjerë.

Më tej ministri Peleshi shtoi se Shqipëria dhe Mali i Zi janë partnerë në organizatën politiko - ushtarake më të madhe në botë, siç është NATO, dhe misioni kryesor në kuadër të këtij partneriteti është mbështetja e vendeve të tjera Ballkanit në rrugën e tyre të integritetit euroatlantik. Mbështetja e “Politikës së dyerve të hapura” të NATO-s është i vetmi mjet i cili realizon qëllimin e përbashkët për një rajon sa më të sigurt”, - u shpreh ministri Peleshi.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime mbi mundësitë për përmirësimin e bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, me qëllim forcimin e rolit të tyre në fushën e sistemit të sigurisë kolektive. Në fund të takimit, të dy ministrat, shprehën angazhimin e tyre se përforsimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal, si edhe orientimi euroatlantik janë komponentët kryesorë në zhvillimin e mëtejshëm të rajonit të Ballkanit.

Olivera Injac është emëruar Ministre e Mbrojtjes e Malit të Zi më 4 dhjetor 2020, në kabinetin e ri të kryeministrit Zdravko Krivokapić. Olivera Injac ka lindur në vitin 1976 në Podgoricë dhe u diplomua në Fakultetin Filozofik në Nikshiq në 1999, dhe përfundoi studimet pasuniversitare në 2005 në Fakultetin e Shkencave Politike në Podgoricë.

Me marrjen e detyrës në fund të vitit që kaloi, ministrja malazeze Olivera Injac është uruar nga ish ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhacka nëpërmjet një bisede online, ndërsa ministrja malazeze Injac ka pritur në një takim në Podgoricë ambasadorin shqiptar në Malin e Zi, zotin Ridi Kurtezi. Bashkëbiseduesit kanë theksuar bindjen e përbashkët se të dy vendet do të angazhohen në zbatimin e agjendës së integritetit europian, me mbështetjen e ndërsjellë, e cila do të vazhdojë të jetë themeli i stabilitetit në rajon.





Gjeneral Bajram Begaj-homologu turk Gjeneral Yaşar Güler

Gjeneral Begaj dhe Gjeneral Güler, bisedë telefonike mbi zhvillimet aktuale

Sipas Agjensise Turke te lajmeve (AA), Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, gjeneral Yaşar Güler, ka zhvilluar më datë 28 qershor 2021, një bisedë telefonike me homologun e tij shqiptar, gjeneral Bajram Begaj. Sipas njoftimit zyrtar të bërë publik nga Forcat e Armatosura Turke (TSK), në faqen e saj elektronike, Güler dhe Begaj shkëmbyen mendime mbi zhvillimet aktuale midis dy vendeve dhe atyre në rajon.

Ndërkohë ka patur edhe vizita të ndërsjellta dhe marrëveshje ushtarake midis dy vendeve. Më 28 mars 2019, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm FA të Turqisë, Gjeneral Yaşar Güler ka zhvilluar vizitë në Shqipëri ku është pritur nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ku ky i fundit ka falënderuar Gjeneral Güler për mbështetjen e gjithanshme të FA turke për transformimin dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura në fusha të ndryshme, si arsimimi, stërvitja, logjistika, etj. Të dy ushtarakët e lartë vlerësuan gjithashtu angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO në Afganistan, si dhe shprehën bindjen se ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen, jo vetëm si dy vende dhe popuj miq, por edhe si anëtarë të Aleancës Euroatlantike. Kurse, në datat 20 dhe 21 qershor 2019, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ka zhvilluar një vizitë zyrtare dy ditore në Turqi me ftesë të homologut turk Güler.

Që nga viti 1998, janë firmosur dhe ratifikuar 26 marrëveshje ushtarake, grante dhe protokolle me Qeverinë e Republikës së Turqisë. Turqia. Ky partner strategjik i vendit tonë, e ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme Shqipërinë në fusha të ndryshme, përfshirë dhe logjistikën ushtarake në përputhje me programin

për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare të vendit tone.

Ndër marrëveshjet më të fundit është ajo e datës 24 mars 2021, lidhur me bashkëpunimin në fushën e Mjekësisë Ushtarake, ku pala turke merr përsipër kurimin falas në institucionet mjekësore ushtarake të anëtarëve aktivë në detyrë të Forcave të Armatosura dhe familjarëve të tyre, personelit në rezervë dhe pension të Forcave të Armatosura dhe personelit civil që punon në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Marrëveshja rregullon trajtimin e studentëve ushtarakë shqiptarë, të cilët studiojnë për mjekësi në Turqi, me bursa falas, si dhe parashikon kurse dhe specializime për rritjen e tyre profesionale.

ANKARA-NËN ORGANIZIMIN E KOMANDËS SË FORCAVE SPECIALE TË TURQISË

Forcat Speciale marrin pjesë në stërvitjen “Anadoly-21”

Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale “Anadoly-21” u zhvillua në fund të muajit qershor, nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Turqisë, me pjesëmarrjen e “Forcave Speciale” nga 7 vende.

Në një deklaratë të Ministrisë turke të Mbrojtjes thuhet se Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale “Anadoly-21” e cila filloi më 28 qershor ishte me pjesëmarrjen “de facto” të elementëve të forcave speciale të Turqisë, Shqipërisë, Azerbajxhanit, Katarit, Kazakistanit, Pakistanit dhe Uzbekistanit ndërsa edhe me pjesëmarrjen si vëzhgues të Kosovës dhe Mongolisë. Stërvitja u zhvillua nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, në Ankara me qëllimin për të zhvilluar miqësinë, bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet elementëve të Forcave Speciale, për të ndarë informacionin dhe përvojën reciproke si dhe zhvillimin e aftësisë për të kryer operacione së bashku.

Baza e trajnimeve ndërkombëtare Hohenfels, Gjermani

Përfundon stërvitja “KFOR - 29”

Nga data 5 deri në 30 qershor, në bazën e trajnimeve ndërkombëtare Hohenfels, Gjermani u zhvillua stërvitja “KFOR-29”. Vendi ynë në këtë stërvitje u përfaqësua nga efektivët e Kompanisë I të Batalionit I të Këmbësorisë (b1k). Në këtë stërvitje morën pjesë gjashtë shtete: Shqipëria, SHBA, Kosova, Moldavia, Maqedonia e Veriut dhe Italia.

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte bashkëpunimi në zona operacionale gjithëpërfshirëse midis shteteve në kuadër të Operacioneve të Mbështetjes së Paqes.

“KFOR-29” bazohet në mjedisin e operacioneve aktuale dhe është i dizajnuar për të përgatitur njësitë për Operacione në Mbështetje të Paqes si dhe në mbështetje të autoriteteve civile. Kjo stërvitje synon rritjen e ndërveprimit të trupave gjatë stërvitjes për Operacionet e Mbështetjes së Paqes dhe praktikimin e procedurave standarde të drejtimit të trupave. Temat kryesore që u zhvilluan duke respektuar të gjitha masat protokollare për mbrojtjen nga virusi COVID-19 ishin: patrullë e kufirit, patrullë me mjete, pikë - vrojtimi dhe kontroll turme. “KFOR-29” rriti më tepër aftësitë individuale ndërvepruese të ushtarakëve shqiptarë në mjediset multinacionale duke rritur njëkohësisht edhe aftësitë profesionale të personelit drejtues oficer dhe nënoficer.

Do të rrisim aftësitë dhe kapacitetet në fushën mbrojtjes të dy vendeve

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral, ditën e mërkurë, më 2 qershor 2021, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Bajram Begaj ka nisur një vizitë zyrtare dy ditore në Kosovë. Me këtë rast, në Ministrinë e Mbrojtjes, me nderimet më të larta ushtarake, ai u prit nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Rrahman Ramaj. Në fillim ai u prit në takim nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj ku u bisedua për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë vëllazëror me gatishmërinë e plotë për realizimin e suksesshëm të planit të përbashkët në funksion të avancimit të mëtejshëm të aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes së dy vendeve si dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

Më pas, gjeneral Rama dhe gjeneral Begaj zhvilluan takimin tërësisht për të vazhduar në takimin në nivel të dy delegacioneve. Me këtë rast, shefi i Departamentit të Planifikimit të SHPFSK-së, kolonel Agron Bajrami ka informuar rreth Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit. Në vazhdim nga ana e gjeneral Ramës u vlerësua lart niveli i deritashëm i bashkëpunimit ushtarak, fokusi i takimit ishte angazhimi i përbashkët për realizimin e planit të përbashkët të veprimit bazuar në Marrëveshjen e re të bashkëpunimit bilateral të nënshkruar para disa ditësh në mes ministrave Mehaj dhe Pelesh. Gjatë diskutimit, gjeneral Rama e njoftoi gjeneral Begajn me zhvillimet në FSK si dhe të arriturat e deritashme, konkretisht me përfundimin e suksesshëm të operacioneve stërvitore në kuadër të "Defender-Europe 21", procesin e realizimit të Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së, pjesëmarrjen e kontingjen-



Gjeneralmajor Bajram Begaj është pritur në Prishtinë nga Armend Mehaj, ministër i Mbrojtjes i Kosovës dhe gjeneralletenant Rrahman Ramaj, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës



tit të parë në operacione ushtarake jashtë vendit, si dhe procesin e bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë. Nga ana e tij, gjeneral Begaj tha se e gëzojnë shumë të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së duke u zotuar për një bashkëpunim edhe më të intensifikuar në të gjitha fushat me mbështetje të rezervë për realizimin e planit të përbashkët të bashkëpunimit si dhe objektivave të përcaktuar të FSK-së në të ardhmen. Më pas, gjeneral Begaj, vizitoi Qendrën Mjekësore të FSK-së ku nga drejtori i saj, Dr. Shkëlzen Syla u informua me organizimin, kushtet, ambientet,

pasjisjet, stafin dhe funksionimin e Qendrës. Në fund të vizitës së ditës së parë, gjeneral Begaj i shoqëruar nga zv.ministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla dhe zv.komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, vizitoi Qendrën për Studime Universitare të Akademisë së Mbrojtjes së FSK-së ku takoi edhe kadetë-studentët e Shqipërisë që studiojnë në këtë qendër krahas njoftimit me organizimin, plan programet dhe funksionimin e saj nga ana e komandantit të QSU-së, major Ali Haxhimustafa. Vizita e gjeneral Begajt dhe delegacionit të tij ka vazhduar edhe ditën e enjte me vizita dhe takime.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ka falenderuar efektivet e Forcave të Armatosura të cilët morën pjesë në stërvitjen e madhe "Defender Evrope 21". Ai ka falenderuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tjerë të NATO-s të cilët zgjedhën vendin tonë për këtë stërvitje dhe ka shprehur gadishmërinë për stërvitje të tjera.

"Defender Evrope 21" ishte një sukses i përbashkët i Forcave të Armatosura dhe të gjitha strukturave të tjera shtetërore të angazhuara në këtë stërvitje. Faleminderit të gjithë ushtarakëve dhe civilëve që u bënë pjesë e kësaj stërvitjeje kaq domethënëse për paqen në rajonin tonë. Mirënjohje gjithashtu për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tjerë të NATO-s që zgjedhën vendin tonë.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi

Jemi të gatshëm të mirëpresim stërvitje të tjera "Defender Europe"

Shqipëria është gjithmonë e gatshme të mirëpresë stërvitjet e viteve në vijim në kuadër të De-

fender Europe", shkruan ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi në faqen e tij në facebook.

Akademia e Forcave të Armatosura

Studentët e rinj ushtarakë do të pajisjen me dopio diplomë

Fuqizimi dhe modernizimi i Akademisë së Forcave të Armatosura sipas modeleve më të mira amerikane dhe europiane, me fokus teknologjinë dhe cyber security është prioriteti më i rëndësishëm i Ministrisë së Mbrojtjes. Viti i ri akademik do të fillojë me disa bashkëpunime të rëndësishme të cilat do t'u mundësojnë studentëve të rinj pajisjen me dopio diplomë, pra bashkë me diplomimin ushtarak, ata do të kenë edhe një formim në një degë tjetër civile. Entuziast nga bashkëbisedimi që pata me brezin e parë të bachelorit pas rihapjes së kësaj akademie", shkruan Ministri Peleshi.



Orkestra e FA-së interpreton për 246 vjetorin e ushtrisë amerikane

Ushtria amerikane ka festuar 246 vjetorin e saj. "Më, 14 qershor, Ushtria Amerikane festoi ditëlindjen e saj të 246-të, duke nderuar guximin e ushtarit amerikan", shkruan Ambasada Amerikane në Tiranë. Sipas ambasadës "në nder të kësaj dite dhe stërvitjeve të suksesshme të "Defender Europe 21", ne kemi kënaqësinë të ndajmë këtë bashkëpunim midis Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Bandës & Korit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Europën dhe Afrikën". Në këtë eveniment artistik u interpretuan edhe dy këngë shqiptare, të orkestruara nga Endri Sina. "Gëzuar ditëlindjen, Ushtria Amerikane!", -uron ambasada Amerikane në Tiranë.

Zëvendësshefe e SHPFA, Manushaqe Shehu merr gradën “gjeneralmajor”

E para grua ushtarake me gradën më të lartë në Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, duke theksuar se ky është një vlerësim për arritjet e saj në karrierë

Në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ditën e martë, më 22 qershor 2021, ceremonia e gradimit të zëvendësshefes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Manushaqe Shehu me gradën “gjeneralmajor”.

Ajo është e para grua ushtarake që mban gradën më të lartë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Gjatë ceremonisë, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, duke theksuar se ky është një vlerësim për arritjet e saj në karrierë. Ministri Peleshi vuri në dukje detyrat e rëndësishme që ajo ka kryer, përfshirë këtu edhe detyra me rëndësi sensitive. Zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, falënderoi autoritetet e larta të Shtetit për vlerësimin e dhënë, duke premtuar se do të punojë me përkushtim e profesionalizëm që t'i shërbejë Forcave të Armatosura dhe ven-

dit me mbështetjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi. Ajo u bëri thirrje grave dhe burrave nën uniformë se me punë të palodhur dhe përkushtim mund të promovohen në gradë. “Shërbimi në FA është sa i vështirë, sakrificë, delikat aq dhe i bukur. E themi këtë për të bërë apel cdo ushtaraku burra apo gra, djem dhe vajza që puna e pa lodhur, përkushtimi, komunikimi me eprorët dhe vartësit është mundësia për të përmbushur objektivat dhe promovuar në gradën e radhës”, tha Gjeneralmajore Shehu. Gjeneralmajor Manushaqe Shehu është titulluar oficer në vitin 1984 dhe në karrierën e saj të gjatë prej 37 vjetësh në uniformë ka shërbyer në disa detyra dhe funksione. Më 14 nëntor 2016 ajo u gradua “gjeneral brigade”, me dekret të presidentit të Republikës Bujar Nishani, ndërsa tashmë ajo mban gradën më të lartë “general major”, me dekret të presidentit të Republikës Ilir Meta, Nr. 13113, datë 17 qershor 2021.



Kush është Gjeneralmajore Manushaqe Shehu

Gjeneral majore Manushaqe Shehu ka lindur në Peshkopi më 5 nëntor të vitit 1965. Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Lartë të Oficerëve në Tiranë në vitin 1984-1988, emërohet Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi. Gjatë viteve 1989-1994, përfundon Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Në vitin 1991 merr gradën Kapiten i Parë. Nga viti 1989-1996, kryen disa detyra të ndryshme në Logjistikë si itendente batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazermimin në brigadë, deri shefe e Logjistikës e Divizionit 1100, Shkodër. Në vitin 1996 emërohet Specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë e mban deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000-2002 punon në ekipin amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si përkthyes, njëkohësisht kryen studime pasuniversitare (Kursin Themelor të

Oficerit në SHPFA dhe Kursin e Funksioneve) në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2003 merr gradën Major dhe emërohet Shefe e Shërbimit të Ushqimit në FA, detyrë që e mban deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, ka qenë nismëtare e disa projekteve të rristrukturimit të FA dhe anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC "për ndryshimin e strukturave të FA", si dhe anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të disa rregulloreve të ndryshme për Logjistikën në FA. Drejtuese e Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe

Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Në vitet 2004-2005 përfundon ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Tur, Francë dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm "Spiro Moisiu", Tiranë. Në vitin 2006 merr gradën Nënkolonel dhe emërohet Shefe e Furnizimit të FA dhe në vitin 2007, Shefe e Protokollit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Më 8 tetor 2007 emërohet Ndihmëse e Presidentit të Republikës, për Çështjet Ushtarake dhe Integrimin Euroatlantik. Gjatë kësaj periudhe përfundon studimet në Kolegjin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2010 përfundon Master Shkencor të Nivelit të Dytë (MND) në fushën e Sigurisë Kombëtare dhe merr gradën "Kolonel". Më 4 shkurt 2011 emërohet Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës. Me 1 shtator 2012 emërohet Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes. Pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s. Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu ka qenë pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s, aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA dhe të rajonit. Gjatë karrierës së saj, ka qenë nismëtare e një sërë projektsh



të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat ka marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura.

Më 1 nëntor 2016 emërohet Komandante e Akademisë së Nënoficerëve. Më 14 nëntor 2016 gradohet "Gjeneral Brigade", e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë që merr këtë gradë. Më 1 dhjetor 2016 emërohet në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinë dhe Stërvitjes. Aktualisht mban vendin e zëvendës-shefes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

SEDMI, dëshmi e bashkëpunimit rajonal dhe sigurisë në Evropën Juglindore

Shqipëria ka përmbyllur kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (South-Eastern Europe Defence Ministerial-SEDM), me takimin e përvitshëm të zhvilluar më 10 qershor 2021 të zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të Iniciativës së SEDM.

Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM, i cili drejtoi përmes video-konferencës këtë takim vlerësoi këtë iniciativë si një histori sukseesi dhe dëshmi të zhvillimit dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Evropën Juglindore.

Ai nënvizoi më tej faktin se bashkimi i forcave ushtarake dhe krijimi i Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore (SEEBRIG), ka kontribuar dhe forcuar më tej sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Zëvendësministri Petro Koçi prezantoi projektet dhe aktivitetet e zhvilluara me sukses gjatë kryesimit të Iniciativës së SEDM nga vendi ynë që nga takimi i vjetshëm i zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të vendeve anëtare të SEDM.

Komandanti i Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore (SEEBRIG), gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos prezantoi në detaje aktivitetet e zhvilluara nga Brigada për periudhën qershor 2020-2021 si dhe analizoi zhvillimin e kapaciteteve dhe angazhimet e ardhshme të SEEBRIG.

Zëvendësshefat e Shtabeve të Përgjithshme të Iniciativës së SEDM mirëpritën arritjet e SEEBRIG dhe vlerësuan kontributin e kësaj Brigade për sigurinë dhe stabilitetin rajonal, duke u shndërruar



Miratohet Deklarata e Përbashkët (Joint Statement) e zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të vendeve anëtare të SEDM



në një platformë unike ushtarake për bashkëpunim dhe trajnim të ndërsjellë.

Më tej, takimi vijoi me pozicionet e vendeve duke theksuar angazhimin për forcimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit si dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak në kuadër të trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Takimi u mbyll me miratimin e

Deklaratës së Përbashkët (Joint Statement) të zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të vendeve anëtare të SEDM.

Zëvendësshefat e Shtabeve të Përgjithshme të Iniciativës së SEDM falënderuan kryetarin e Sekretariatit të SEDM dhe shprehën vlerësimet e tyre për kryesimin me sukses të Sekretariatit të SEDM nga Shqipëria për periudhën 2019-2021.



Në kuadrin e iniciativës SEDM, ku Shqipëria mban kryesimin për periudhën 2019-2021, u zhvillua takimi i Zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore, ku Kroacia ishte në rolin e vendit pritës.

Për shkak të COVID-19 takimi u zhvillua online me VTC. Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan nga Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Manushaqe Shehu dhe stafi mbështetës nga Drejtoria e NATO-s & BE dhe Drejtoria e Planifikimit të Mbrojtjes J 5/8, në SHPFA.

Takimi u hap nga Zëvendësministri i Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë z. Petro Koçi në rolin e kryetarit të SEDM-CC/PMSC. Më tej në rolin e vendit pritës përshëndeti zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Kroacisë, Gjeneralallejtënant Siniša Jurković.

Më tej Komandanti i SEEBRIG-ut, Gjeneral Brigade Aristeidis

Takohen Zëvendësshefat e Shtabit të Përgjithshëm të Evropës Juglindore

Forcat tona të Armatosura u përfaqësuan nga Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Manushaqe Shehu



Iliopoulos mbajti një prezantim mbi aktivitetet dhe veprimtarinë e kësaj brigade nga takimi vitit të kaluar mbajtur në Bukuresht të Rumanisë dhe deri tani. Në fund

të takimit pjesëmarrësit dolën me një deklaratë të përbashkët. Takimi i radhës sipas kalendarit do të zhvillohet në Lubjanë, Slloveni, në muajin qershor 2022.

Misioni "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan

Trupat e Kontingjentit VI paqeruajtës të Batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjentit XIII paqeruajtës të Batalionit II të Këmbësorisë që morën pjesë në misionin "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan, më datë 20 qershor 2021, janë kthyer në atdhe pas përmbushjes së detyrës.

"Mirë se erdhët në atdhe!" - Kthehet Kontingjenti VI paqeruajtës i batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjenti XIII paqeruajtës i batalionit të dytë të këmbësorisë, që morën pjesë në misionin "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan", - shkruan ministri Peleshi.

Ndërsa në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, në mjediset ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, morën pjesë zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe atashë ushtarak i Republikës së

Kthehen Kontingjenti VI dhe XIII i Forcave Speciale dhe Këmbësorisë

Ky është kontingjenti i fundit në Afganistan, i cili përmbylli një kapitull krenarie për Forcat e Armatosura në operacionet e mbështetjes së paqes, të udhëhequra nga NATO

Turqisë kolonel Muhammet Kelami Kablay, si dhe familjarët e efektivëve. Në fjalën e tij, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji theksoi: "Nga ky vend ku jemi mbledhur, kemi përcjellë dhe pritur shumë kontingjente ndër vite, por ky i sotmi është më i veçantë. Ju jeni kontingjenti i fundit në misionin paqeruajtës RSM duke përmbyllur një tjetër kapitull historik krenarie të kontributit të Forcës Tokësore në operacionet e mbështetjes së paqes, të udhëhequra nga NATO. Eksperiencia e përfutur është një mundësi e shkëlqyer, ku mësimet e nxjerra do t'i përdorim në të ardhmen në trajnim,

edukim dhe stërvitje."

Ky mision ka qëndruar për 6 muaj në Afganistan. Ai u nis nga Shqipëria të martën, më 8 dhjetor 2020, ku ishte i pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjeneralmajor Bajram Begaj. Misioni VI i Resolute Support Mission në Kabul është kontingjenti i fundit që shërben në Afganistan. Forca Tokësore që në fillimet e pjesëmarrjes në misionet ndërkombëtare në Afganistan në 2002 është përfaqësuar në të gjitha komandat rajonale si Herat, Mazar-i-Sharif, Kabul dhe Kandahar.



SARAJEVË, BOSNJË-HERCEGOVINË

Gjeneralmajor Begaj në Konferencën e 14-të të Shefave të Shtabit të Vendeve Ballkanike

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në Konferencën e 14-të të Shefave të Shtabit të Vendeve Ballkanike (BCHOD) të organizuar në Sarajevë dhe Bosnje. Përveç delegacioneve nga nëntë vendet ballkanike anëtare të iniciativës, të ftuar në këtë takim ishin edhe shefat e Shtabit të Kroacisë dhe Sllovenisë, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, zëvendëskomandanti i Komandës së Bashkuar të NATO-s në Napoli, si dhe përfaqësues nga Komiteti Ushtarak i Bashkimit European.

Në konferencë u prezantuan dhe miratuan raportet vjetore të Grupit të Koordinimit, Nëngrupit të Punës mbi Kërcënimet Asimetrike dhe Nëngrupit të Punës së Edukimit, Trajnimit dhe Stërvitjes. Në përfundim të konferencës u nënshkrua një



Morën pjesë Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Shqipëria dhe Turqia

deklaratë e përbashkët nëpërmjet së cilës shefat e shtabeve riafirmuan vendosmërinë e tyre për të forcuar bashkëpunimin midis Forcave të Armatosura.

Gjithashtu gjatë këtij aktiviteti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi takime të veçanta me homologët e Turqisë dhe Maqedonisë së Veriut, ku u diskutua mbi planet e bashkëpunimit dypalësh midis Forcave të Armatosura të vendeve respektivë. Konferenca e shefave të Shtabit të Ballkanit

është një iniciativë rajonale vjetore me bazë rotacioni, e themeluar në vitin 2007 në të cilën marrin pjesë Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Shqipëria dhe Turqia. Qëllimi kryesor i këtij forumi është rritja e bashkëpunimit ushtarak në të gjitha nivelet dhe përmirësimi i kapaciteteve të shteteve të rajonit në mënyrë që ata të mund t'i u përgjigjen respektivisht rreziqeve potenciale me natyrë asimetrike dhe krizave me origjinë jo-ushtarake.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi më 3 qershor, një vizitë zyrtare në Komandën e KFOR-it, ku u prit nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici. Gjeneralmajor Begaj shprehu mirënjohjen ndaj burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë e këtij misioni.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Federici vlerësoi maksimalisht performancën e personelit ushtarak shqiptar që shërbejnë në KFOR. Në takim u vlerësua roli i KFOR-it si një ndër aktorët kyç në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit. Të dy liderët ushtarakë ndanë të njëjtat vlerësime dhe qasje mbi sfidat aktuale të sigurisë me të cilat përballlet rajoni duke u fokusuar në impaktin e krijuar ndaj aktivitetit të forcave ushtarake nga kriza e pandemisë. Në përfundim të dy bashkëbiseduesit theksuan rolin e NATO-s në përballimin e sfidave si dhe forcimin e bashkëpunimit mes FARSH-it dhe KFOR-it edhe në të ardhmen.

Gjeneralmajor Begaj u takua edhe me personelin e FARSH-it që shërben në KFOR, ku u njoh me de-tyrat dhe përgjegjësitë e personelit

Gjeneralmajor Federici vlerëson personelin ushtarak që shërben në KFOR

KFOR-i ka rol të rëndësishëm në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit



të FARSH-it në këtë mision tepër të rëndësishëm dhe të vlerësuar nga NATO. SHSHPFA i falënderoi ata për performancën, dedikimin dhe angazhimin e tyre si ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në këtë

operacion shumëkombësh. Personeli i FARSH-it ka qenë vlerësuar me medaljen e NATO-s "Jo-Artikull 5", të dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për shërbimin e tyre në KFOR.

Stërvitja "Defender Europe-21"

Në Bazën Ajrore Kuçovë u zhvillua më 8 qershor, ceremonia e dhënies së medaljeve personelit ushtarak të Mbështetjes Logjistike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pjesëmarrës në Stërvitjen "Defender Europe-21". Në këtë ceremoni, të drejtuar nga nënkolonel Andrea Talbert, morën pjesë edhe komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Ollidashi, zëvendëskomandanti i Bazës major Leandro Zyka dhe ushtarakë pjesëmarrës në stërvitje.

Në fjalën e saj të përshëndetjes, nënkolonel Talbert falënderoi

Medalje në Kuçovë për ushtarakët amerikanë



trupat amerikane për kontributin e tyre në Stërvitjen "Defender Europe-21" si dhe gjithashtu adresoi një falënderim të veçantë për Komandën e Bazës Ajrore Kuçovë për mikpritjen dhe mbështetjen e tyre gjatë Stërvitjes "Defender Europe-21". Në fund, me një solemnitë u shpërndanë medaljet për personelin ushtarak amerikan.

Anija “Oriku” P-132, në Slloveni, në stërvitjen “Adrion-LivEx-2021”

Morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare, sllovene, greke, italiane, kroate, të Malit të Zi dhe shqiptare

Në përfundim të stërvitjes Adrion Livex-21, stërvitje e zhvilluar nga data 29 maj deri më datë 7 qershor 2021, në Koper, Slloveni është zhvilluar dita e vizitorëve të shquar në të cilën morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare, sllovene, greke, italiane, kroate, të Malit të Zi dhe ato shqiptare.

Në DVD mori pjesë komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari. Në stërvitjen e zhvilluar në Koper Slloveni Forca Detare mori pjesë me anijen e klasit Iliria P-132 Oriku.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes u trajtuan rëndësia mbi bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon. Gjithashtu u diskutua mbi rëndësinë e vijimit të iniciativës Adrion, për rritjen e sigurimit detar të rajonit, për forcimin dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së operacioneve të kërkim-shpëtimit në det.

Të pranishmit i përshëndeti shefi i shtabit të Forcave të Armatosura të Sllovenisë, komandanti i Njësisë Detare sllovene dhe më pas aktiviteti vijoi me një material prezantues për stërvitjen e zhvilluar nga forcat dhe mjetet pjesëmarrëse.

Qëllimi i kësaj stërvitje është perfeksionimi i elementëve të Livex, Passex dhe koordinimi i veprimeve të ekuipazheve dhe anijeve pjesëmarrëse gjatë zhvillimit të operacioneve të kërkim - shpëtimit në hapësirën detare të Adriatikut e Jonit, në rajone të përbashkëta.



Bashkëpunim me Flotën Detare të Mbretërisë së Bashkuar

Anija P-133 “Butrinti” stërvitje me atë britanike “HMS Trent P-224”

Stërvitja u zhvillua në ujrat tona teritoriale për rritjen e koordinimit midis anijeve sipas standardeve të NATO

Në kuadër të bashkëpunimit midis Flotës Detare të Mbretërisë së Bashkuar dhe Flotës Detare të Republikës së Shqipërisë, gjithashtu edhe në kuadër të bashkëpunimit midis vendeve anëtare të NATO, nga data 10.6.2021 deri në datën 14.6.2021 në rajonin e Vlorës është duke kryer vizitë portuale anija “HMS TRENT P-224”. Gjatë hyrjes në ujërat territoriale shqiptare, anija britanike zhvilloi me sukses stërvitjet me anijen e Flotiljes Detare Pashaliman P-133 “Butrinti” për rritje koordinimi dhe profesionale midis anijeve sipas standardeve të NATO. Për t'i uruar mirëseardhjen në Shqipëri, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman kapiten i Rangut II Sabri Gjinollari, zhvilloi një vizitë në anijen britanike. Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit aktual dhe mundësinë e stërvitjeve të përbashkëta në të ardhmen midis dy flotave detare. Gjithashtu, sipas traditës detare, u shkëmbyen dhurata kortezie midis komandantit të anijes “HMS TRENT P-224” dhe komandantit të Flotiljes Detare Pashaliman.



Përfundon aktiviteti në Qendrën Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak

Paraditen e datës 28 maj, në Bazën Detare Pashaliman u zhvillua ceremonia e mbylljes së aktivitetit të Qendrës Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (MNCC). Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Në fjalën e tij gjeneral brigade Xhebexhia duke falënderuar kolegët e MNCC u shpreh se ka qenë kënaqësi, përgjegjësi dhe privilegj për Forcën Detare të mirëpresë MNCC në Bazën Detare të Pashalimanit.

Flotilja Detare dhe MNCC përfituan nga ky rast për t'u trajnuar dhe stërvitur së bashku. Demonstrimi që u përgatit për ditën e hapur nga të dy ekipet, ku pjesëmarrës ishin ministri i Mbrojtjes dhe ambasadorët e vendeve të përfaqësuara në stërvitje, tregoi se së bashku mund të arrijmë shumë. Shqipëria është një vend i vogël, por stërvitja "Defender Europe 21" tregoi që çdo aleat dhe partner, pavarësisht madhësisë dhe kapacitetit që disponon, mund të kontribuojë për Aleancën. Shqipëria, duke vendosur në dispozicion të stërvitjes, eksperiencën dhe njohuritë e saj mbi rajonin, si dhe kapacitetet e saj kombëtare të tilla si portet, aeroportet, bazat dhe asetet ushtarake, bëri që "Defender



Europe 21" të ishte një stërvitje e suksesshme. Në fund komandanti i Forcës Detare, i uroi gjithsecilit udhëtim të mbarë për në vendet e tyre me shpresën se do të shihemi përsëri në stërvitjen "Defender Europe 23". Gjithashtu, komandanti i Flotiljes Detare, kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari në

fjalën e tij falënderoi komandantin e MNCC-së, nënkolonel Larson për bashkëpunimin e treguar në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta stërvitore. Në përfundim të ceremonisë, kapiten i rangut të II-të Gjinollari i dhuroi nënkolonel Larsonit simbolin e Flotiljes Detare në shenjë falënderimi.

Stërvitja "Defender Europe 21"

Trupat tona në Kroaci: Përfundon stërvitja e zbulimit "Laufer-21"

Në kuadër të paketës së stërvitjeve "Defender-21", në periudhën 16-29 maj në Kroaci u zhvillua stërvitja ndërkombëtare e zbulimit "Laufer-21". Në këtë stërvitje Shqipëria u prezantua me një personel prej 11 ushtarakësh, efektivë të Kompanisë së Zbulimit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte ndërveprueshmëria midis trupave të vendeve aleate, grumbullimi i informacionit duke përdorur disiplinat kryesore të zbulimit dhe zbatimi i ciklit të zbulimit. Trupat e Kompanisë së Zbulimit janë vlerësuar nga drejtuesit për performancën e lartë të treguar gjatë stërvitjes "Laufer-21". "Defender Europe 21" është stërvitja më e madhe ushtarake e zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria ishte vendi kryesor pritës.



Në ambientet e Bazës Ajrore Farkë u zhvillua më 4 qershor, testimi teorik përfundimtar me 12 kursantët e Kursit Bazë të Oficerit, specialiteti “Pilot ushtarak helikopteri” në prani të komisionit të përbërë nga personel i Akademisë së Forcave të Armatosura, Bazës Ajrore Farkë dhe Qendrës Stërvitore të FAj, Kuçovë.

Gjatë kësaj faze të rëndësishme arsimimi, e cila kishte filluar në muajin mars të këtij viti, kursantët u pajisën me dijet e domosdoshme aeronautike para fillimit të fluturimeve dhe studiuin lëndët si teori fluturimi e aerodinamikë të helikopterëve, konstruksion motori dhe helikopteri, instrumentet, pajimet elektrike e speciale, navigim, radio-navigim, ligjet e ajrit, komunikim ajror, meteorologji, siguri fluturimi etj. Në përfundim të çdo lënde kandidatët kanë kryer teste të veçanta duke përmbyllur modulet me këtë testim teorik përfundimtar me shkrim dhe pyetje-përgjigje mbi dijet e fituara.

Me përfundimin me sukses të testimit, kursantët për “Pilot ushtarak helikopteri” do të fillojnë fazën tjetër të përgatitjes në tokë para se të nisin fluturimet, si dhe do t’i caktohen instruktorët e fluturimit, të cilët do t’i pajisin ata me njohuri dhe informacione të rëndësishme rreth mjetit ajror në të cilin do të fluturojnë, rastet e veçanta, emergjencat në fluturim, instruksionin e teknikës së pilotimit dhe teknikës së shfrytëzimit si dhe procedurat e aerodromit ku do të fluturojnë.

Kurikula e këtij kursi është bazuar në programet e eksperiencat më të mira të vendeve anëtare të NATO-s, ndërsa trupa pedagogjike, e cila zhvillon lëndët mësimore, përbëhet nga ekspertë të Forcës Ajrore, specialistë pilotë, inxhinierë aviacioni, teknikë aviacioni, kontrollorë të trafikut ajror, specialistë meteorologjie e specialitete të tjera, të cilat përgatisin dhe formojnë pilotët e

Përfundon testimi teorik për specialitetin “Pilot ushtarak helikopteri”

Komisioni përbëhet nga përfaqësues të Akademisë së Forcave të Armatosura, Bazës Ajrore Farkë dhe Qendrës Stërvitore të FAj, Kuçovë



ardhshëm të Forcës Ajrore.

Në përfundim të këtij kursi, pilotët e rinj dhe Forca Ajrore do të ofrojnë operacionalitet në të

gjitha operacionet ajrore që kryen FARSH-i në vendin tonë dhe në ato në bashkëveprim me vendet anëtare të NATO-s.

Qendra Stërvitore, Pashaliman

Përfundon kursi i Avancuar i Oficerit, për gradën kapitenlejtënant

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar në mjediset e Qendrës Stërvitore, Pashaliman në certifikimin e kursantëve, të cilët përfunduan kursin e Avancuar të Oficerit, për gradën kapitenlejtënant. Në ceremoni gjithashtu ka marr pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, komandanti i Qendrës Stërvitore kapiten i rangut II Bimir Likaj, si dhe personel i Qendrës Stërvitore. Kursi i Avancuar i Oficerit u zhvillua në një periudhë 12 javore, në të cilën morën pjesë shtatë oficerë. Kursantët gjatë kësaj periudhe kanë treguar disiplinë të lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Trajnimi i kursit pati kryesisht mësim teorik si njohuri mbi operacionet detare, gërshetuar këto në veprime praktike, të cilat u zhvilluan dhe në det sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare.

Fillon stërvitja fushore/ujore “Rreth - Grethi 21”

Nga data 12 qershor, Batalioni i III-të i Këmbësorisë është dislokuar në zonën e Rreth - Grethit, Rrogozhinë, për të zhvilluar stërvitjen fushore/ujore “Rreth - Grethi 21”.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të

përballimit të emergjencave civile. Hapjen e kësaj stërvitjeje e ndoqi nga afër komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili përgëzoi efektivet e këtij batalioni për punën dhe përkushtimin e treguar në ngritjen e fushimit dhe të gjitha përgatitjet për fillimin e kësaj stërvitjeje. Stërvitja “Rreth - Grethi 21” është stërvitja e parë fushore/ujore, e cila do të vijojë të kryhet dhe nga repartet e tjera të Forcës Tokësore.



Në Bazën Ajrore të Kuçovës, është ngritur një ndër 5 qendrat logjistike të stërvitjes ushtarake të NATO-s, “Defender Europe 21”. Së shpejti në Bazën Ajrore të Kuçovës nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s. “Defender Europe 21” nga Baza Ajrore e Kuçovës, ku është ngritur një ndër 5 qendrat logjistike të stërvitjes dhe ku së shpejti nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s”, -shkruan Kryeministri Rama. “Qendra logjistike mbështet stërvitjen me transport, karburant, çadra, ushqim dhe çdo gjë tjetër. Në Kuçovë u instalua edhe sistemi amerikan i raketave ‘Patriot’. Gjithashtu në Kuçovë policia ushtarake shqiptare dhe amerikane po zhvillojnë stërvitje

Baza Ajrore e Kuçovës, një ndër 5 qendrat e stërvitjes “Defender Europe 21”

Së shpejti nis investimi për aeroportin e ri ushtarak të NATO-s

të përbashkët. Rruga e rindërtuar rishtas mundëson akses më të lehtë në bazën ajrore”, -thuhet në video.

“Defender Europe 21” është stërvitja më e madhe ushtarake që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Rreth 28 mijë trupa nga SHBA, por edhe nga vendet e tjera, aleate të NATO, po demonstrojnë një rritje të aftësive ushtarake për të bashkëpunuar si aleatë ushtarakë.



USHTRIA RINDËRTON URËN “BAILEY” NË DARËZEZË Zv/ministri Koçi “teston” urën e re me kamion

Ushtria përfundoi më 12 qershor, rindërtimin e urës së Darëzezës të Fierit, e cila u prish me 4 qershor sepse kaloi mbi të një kamion me ngarkesë 50 ton, peshë kjo shumë më madhe se ajo që mund të mbante ura. Theksojmë që kapaciteti mbajtës i urës ishte 15 ton.

Forcat xheniere të ushtrisë u angazhuan me tërë kapacitetet e tyre dhe në një kohë rekord i përfunduan punimet duke e ngritur përsëri urën metalike “Bailey”. Zv. ministri i Mbrojtjes zgjodhi vetë ta testonte i pari urën duke i hipur një kamioni që kaloi sipër. Është e sigurt. Prishja e urës pengoi lëvizjen e mijëra banorëve të zonës për disa ditë më radhë, ndërsa policia procesoi penalisht drejtuesin e kamionit, i cili nuk mori parasysh peshën që mund të mbante ajo.



Përfundon Kursi Bazë i Avancuar i Nënoficerit: specialiteti “Forcë Ajrore”

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore në Kuçovë, u zhvillua më 26 maj, ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit në specialitetin “Forcë Ajrore”. Në këtë aktivitet mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore major Ervin Demo, komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Ollidashi, kursantët e të dy kurseve të sapo certifikuar si dhe stafi dhe instruktorë të kësaj qendre.

Kolonel Ylli Pulaj, në fjalën e tij përshëndetëse përgëzoi nënoficerët për seriozitetin e përkushtimin e treguar gjatë kësaj faze arsimimi duke theksuar se, ky kurs institucional është i rëndësishëm jo vetëm për konkurrimin e promovimin në gradën e tetarit dhe të rreshterit, por gjithashtu përmirëson dijet profesionale të nënoficerëve të Forcës Ajrore, të cilët do të shërbejnë në teknikën ajrore si dhe hap rrugën për ndjekjen e kurseve të tjera funksionale, që vlejnë për një karrierë më të gjatë e të merituar në Forcën Ajrore.

Më pas, zëvendëskomandanti



i Forcës Ajrore një falënderim të veçantë adresoi për drejtuesit dhe instruktorët e Qendrës Stërvitore, të cilët me përkushtim zhvilluan programin e këtyre kurseve duke bërë të mundur pajisjen me njohuri të përgjithshme të nënoficerëve. në specialitetet

e teknikës në Forcën Ajrore.

Kolonel Pulaj në përfundim të fjalës përshëndetëse, inkurajoi stafin dhe nënoficerët të punojnë me optimizëm, kurajë dhe përkushtim për realizimin e objektivave, detyrave dhe përballimin e sfidave të përbashkëta.

Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse

Përfundon Kursi Bazë i Nënoficerit në katër specialitete

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit, specialiteti logjistikë/furnizim si dhe transport - mirëmbajtje dhe xhenio. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zyla, si dhe komandantët e reparteve të Komandës Mbështetëse.

Në fjalën përshëndetëse shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse



kolonel Çela falënderoi kursantët për rezultatet e arritura, instruktorët e tyre, si dhe një falënderim të veçantë për komandantin e Qendrës Stërvitore për punën e palodhur. Kolonel Zyla përgëzoi kursantet për angazhimin maksimal që ata dhanë për të përvetësuar njohuritë edhe i uroj atyre suksese në karrierën ushtarake. Në kurse morën pjesë 13 vetë, kursantet ishin kryesisht nga Batalioni i Xhenios. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët.

Helikopteri i Bazës Ajrore Farkë, "Cougar" kreu me sukses misionin e kërkim-shpëtimit për dy turistët polakë, të cilët kishin mbetur të bllokuar në zonën e Thethit. Helikopteri "Cougar" me pilotin nënkolonel Agim Sallaku dhe ekujpazhin i tij kanë bërë të mundur transportimin në rrugë ajrore të turistës polake, e cila kishte pësuar dëmtime fizike nga vendi i quajtur "Maja e Alisë", në Theth për në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë. Gjatë fazës së përgatitjes për këtë mision ka qenë i pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, ndërsa vetë misionin e ka ndjekur komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata. Gjithashtu helikopteri EC 135 me pilot Hamit Hoxha ka kryer

Helikopteri "Cougar" shpëton dy turistët polakë, të bllokuar në Theth



misionin e ambulancës ajrore duke transportuar një të lënduar nga Spitali i Peshkopisë për në Spitalin Universitar të Traumës

në Tiranë për një shërbim më të specializuar, bazuar në njoftimin e Qendrës Kombëtare të Urgjencave Mjekësore.

Studentët e kursit të KLO në konferencën fiktive për shtyp

Në kuadër të programit mësimor të KLO nga data 9-17 qershor është zhvilluar stërvitja "Përpyjekje e përbashkët 21". Duke marrë shkas nga kjo stërvitje në datë 16.6.2021 pranë ambienteve të Qendrës së Simulimit u zhvillua një konferencë për shtyp, fiktive në të cilën kursantët u gjendën nën "presionin" e gazetarëve. Kjo ishte një situatë për të testuar sjelljen e tyre nëse ata do të mund të jepnin përgjigjet e duhura nën "trysninë" e medias. Të pranishëm në konferencën për shtyp ishin Kolonel Edmond Sardi, Nënkolonel Gentian Bardhi, Nënkolonel Dashnor Beta të shoqëruar edhe nga pjesëtarë të tjerë të departamentit të operacioneve.

Konferenca njëkohësisht u ndoq live dhe nga pjesa tjetër e studentëve të cilët nuk mundën të ishin të pranishëm fizikisht. Ky kurs në total kishte 19 studentë dhe në këtë grup 4 prej studentëve ishin nga Kosova. Situata e krijuar kishte të bënte me zbulimin e disa varreve masive në zonën e emëruar "Akademia" këto varre i përkisnin popullsisë

Zhvillohet stërvitja "Përpyjekje e përbashkët 21"

Në stërvitje morën pjesë 19 kursantë ku 4 prej tyre ishin kursantë nga Kosova



lokale dhe pretendohet se vrasja e tyre ishte bërë nga forcat speciale të Nato-s. Konferencën e drejtoi oficeri i informimit public, cili dha edhe mesazhin e parë për mediat duke i falënderuar për pjesëmarrjen duke kërkuar mirëkuptimin nga ana e tyre në rast se do të kishte pyetje të cilat

ata nuk do të mund të përgjigjeshin pasi mund të përbënin sekret për misionin e tyre. Më pas studentët u gjendën para pyetje të gazetarëve, pyetje të formave të ndryshme, por që studentet e KLO-së iu përgjigjën me sukses.

Hajrie Dedaj

“Defender Europe 21”

Shqiptarja refugjate, sot pilote në ushtrinë amerikane

Ambasada Amerikane në Shqipëri ka publikuar një shkrim që tregon historinë e pilotës Valdetë Mehanja e cila për herë të parë vizitoi Shqipërinë me stërvitjen e për bashkët të “Defender Europe 21”, nën uniformën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

NGA SGT. JACCOB HEARN

Nëse ka njeri që e njeh punën e palodhur dhe vendosmërinë, ajo është Togërja e 2-të Valdetë Mehanja, pilote amerikane me Regjimentin e Aviacionit 1-131. Mehanja, shqiptare e lindur në Kosovë dhe shtetase amerikane, nuk e mendonte kurrë se do mund të shihte Shqipërinë. “Unë nuk e kisha vizituar kurrë Shqipërinë më parë. Është një ndjenjë e jashtëzakonshme të jem këtu, si pilote, në uniformë dhe me Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara”, -tha ajo. “Unë nuk do ta kisha pasur kurrë këtë mundësi për të fluturuar rreth Shqipërisë nëse nuk do të ishte për Ushtrinë. Mundësia për ta përjetuar këtë, më bëri shumë të lumtur”.

“Unë nuk do ta kisha pasur kurrë këtë mundësi për të fluturuar nëpër Shqipëri nëse nuk do të ishte ushtria. Të jem në gjendje ta përjetoja këtë thjesht më bëri të lumtur.” Mehanja thotë se ky mision e bën të ndihet si “plotësimi i një rrethi”. Ajo u rrit e varfër dhe familja e saj ishin refugjat të luftës, duke lënë pas ato pak

që kishin për t'i mbijetuar një konflikti të dhunshëm. Vite më vonë, si kontraktuese për Departamentin e Mbrojtjes, autokolona e saj që udhëtonte për në Bagdad ra në pritë nga mjete shpërthyes të improvizuara dhe të shtëna me armë zjarri.

“Mendova se kaq ishte,” -tha ajo. Sidoqoftë, ajo u shpëtua nga pilotët amerikanë dhe ajo e dinte se çfarë tashmë duhet të bënte. “Kjo më bëri të dëshiroj të bashkohem me aviacionin. E dija që kisha një mision më të madh. Nuk mund të isha thjesht një person i rregullt dhe të mos kthehesha”. Që atëherë Mehanja e ka arritur atë qëllim dhe është bërë një pilote e UH-60 Black Hawk për Ushtrinë e SHBA-së. Ajo ndjeu që rrethi së shpejti do të ishte i plotë kur dëgjoi se 1-131 po shkonte në Shqipëri për të marrë pjesë në “Defender Europe 21”.

“Isha aq e ngazëllyer. Nuk mund ta besoja që njësisë e Gardës në të cilën unë u bashkova po shkonte në Shqipëri,” -tha ajo “Nuk e kuptova sa i bukur është ky vend derisa të fluturoja përreth maleve. Unë nuk mendoj se mund të kisha vizituar Shqipërinë në një mënyrë më të mirë.” Mehanja ndihet e fortë për “Defender Europe 21”, i cili është misioni i saj i parë që fluturon jashtë SHBA-së.

“Defender Europe 21” është një shenjë e aleancës,” -tha ajo. “Edhe gjatë një pandemie, ne jemi në gjendje të tregojmë se si mund të lëvizim shpejt në një qark tjetër dhe të punojmë me ushtarakë të tjerë dhe të ndërtojmë partneritete.” Që kur mbërriti në Shqipëri, Mehanja ka fluturuar në misione dhe ka shërbyer si interprete dhe këshilltare kulturore për Amerikanët dhe Shqiptarët që punojnë së bashku. Ajo thotë se ka qenë e lumtur të marrë përsipër detyrat shtesë. “Nëse punojmë së bashku, do të jemi më të fortë së bashku,” -shpjegoi ajo.

“Unë mendoj se për të mbajtur atë partneritetet dhe misionet e vazhdueshme



dhe trajnimin së bashku do të hapë një dritare krejt tjetër për të përjetuar kultura të tjera.”

Jashtë këtyre detyrave, Mehanja është bërë disi e famshme. Ajo është takuar me qindra vendas, është intervistuar nga media të shumta, u takua me Ambasadorin e SHBA-së Yuri Kim dhe i dha dorën Presidentit të Shqipërisë Ilir Meta. “Kjo nënkuptonte aq shumë sa ata po pranonin se sa i vështirë ishte udhëtimi im dhe se ata janë krenarë që jam këtu dhe po punoj së bashku me ta,” -tha ajo.

“Ishte një moment shumë i veçantë për mua dhe nuk do ta harroj kurrë. Do ta çmoj atë për gjithë jetën time.” Familja Mehanja është tepër krenare për të. “Është një marrëveshje e madhe,” -tha ajo, “Unë nuk mendoj se nëna ime, e cila nuk u lejua të shkonte në shkollë, do të kishte menduar ndonjëherë



se vajza e saj do të shtrëngonte duart me një president shqiptar. Familja ime është ashtu krenare që kam qenë në gjendje të vij këtu si një pilote ushtarake amerikane dhe të punoj me shqiptarët dhe që mund të ndihmoj “.

Përkundër gjithë kësaj, ajo mbetet e përlur dhe shpreson që historia e saj të frymëzojë të tjerët dhe të ndihmojë në ndërtimin e miqësive midis kombeve të saj.

“Çdo gjë është e mundur nëse punoni shumë për të. Vetëm kur mendoni se nuk mund të arrini diçka sepse udhëtimi është shumë i vështirë, kjo nuk do të thotë se është e pamundur dhe se nuk do të ndodhë kurrë,” -tha ajo.

“Unë isha në gjendje ta bëja këtë pavarësisht nga shanset kundër meje. Çdokush mund ta bëjë gjithashtu. Unë shpresoj që të gjithë do të frymëzohen për të arritur qëllimet e tyre.”

Mehanja nuk beson se do të ishte aq e suksesshme pa Regjimentin 1-131 të Aviacionit dhe Gardën Kombëtare të Alabama. “Unë seriozisht kam njësinë më të mirë. Unë kam komandantin më të mirë. Unë kam qenë me fat. Ata më kanë lejuar të kem këtë përvojë, të jem pjesë e kësaj. Ishte puna e Zotit dhe të gjithë këtu që e bënë të mundur këtë, dhe Dua t’i falënderoj ”.

Kapiten-Leitnant Ormeni:

Kapiten-Leitnanti shqiptar i Forcës Detare, Eldi Ormeni ndihmoi në drejtimin e anijes së “Defender Europe 21”, në operacionin më të madh të stërvitjes në Ballkan që u zhvillua në vendin tonë. Si oficer ndërlidhje (LNO), është detyra e Ormenit që të sigurojë lidhjen midis personelit shumëkombësh ushtarak dhe civil të përfshirë në stërvitjet “Defender Europe 21”. Ormeni ka punuar edhe jashtë orarit të punës për të ndihmuar në lehtësimin e operacioneve logjistike në Portin e Durrësit, organizimin, koordinimin, drejtimin dhe përkthimin për personelin shqiptar, të SHBA-së dhe të MB në mënyrë që të sigurojë unitetin e përpjekjeve midis ekipeve shumëkombëshe ndërsa ato punuan së bashku gjatë operacioneve të mëdha që sollën mijëra pajisje dhe furnizime në Shqipëri.

Shqiptari është shprehur se në bordin e anijes mësoi rëndësinë e gjendjes morale dhe përpiqet të nxisë një frymë miqësie midis trupave amerikane dhe shqiptare që jetojnë dhe punojnë së bashku këtu. “Ne jemi përpjekur të krijojmë aktivitete të ndryshme midis forcave shqiptare dhe atyre amerikane që ata të mund

Trajnimi me efektivë të SHBA-së është shumë i rëndësishëm



të krijojnë atë marrëdhënie me njëri-tjetrin”, -tha ai. Ai shtoi se këto marrëdhënie janë të rëndësishme sepse përveç stërvitjes ku ata po fitojnë profesionalizëm, gatishmëri dhe aftësi drejtuese, si dhe zgjerojnë ndërveprimin midis kombeve partnere, ata gjithashtu po njihen me njëri-tjetrin dhe përdoruesit e miqësi dhe besim që do të lejojnë

të punojnë së bashku pa probleme në misionet e ardhshme. “Ne kemi ekipin e zhytjes së Shqipërisë i cili ka bashkëpunuar me ekipin e zhytjes së ushtrisë amerikane, duke punuar së bashku dhe duke u stërvitur në ujërat tona. Ata po eksplorojnë ujërat tona dhe po ndajnë përvojë me njëri-tjetrin dhe duke mësuar nga njëri-tjetri”, -tha Ormeni. Sipas Ormenit, komandantët shqiptarë dhe amerikanë kanë qenë shumë dakord në këto misione të përbashkëta stërvitore. “Për mua, të bëj një nga trajnimet e mia të zhytjes me zhytës të SHBA-së është shumë e rëndësishme. Kjo më bën më të sigurt dhe e di se ai do të bëjë një punë të shkëlqyer në det. Së bashku nuk na mundin dot. Ne jemi më të fortë së bashku”, -tha ai. “Defender Europe 21” është një stërvitje në shkallë të gjerë e udhëhequr nga ushtria Amerikane, e krijuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin midis SHBA-së, aleatëve të NATO-s dhe ushtrive partnere.

Pjesëmarrës në mision: KFOR nderon me medalje ushtarakët e FA

Misioni i KFOR-it në Kosovë ka nderuar me medaljen e NATO-s, "NATO non article 5 Ballkan Medal", nënkolonel Arjan Rroshi, nënkolonel Lulzim Hoxha, kapitene Elisabeta Alcani dhe kapitene Anita Gruda, pjesë e kontigjentit aktual të Forcave të Armatosura shqiptare në KFOR. Medaljet iu dorëzuan ushtarakëve shqiptarë nga Komandanti i KFOR-it gjeneralmajor Franco Federici dhe generalbrigade Gunter Schopf, zëvendës komandant i misionit.

Medalja e "Jo-Artikullit 5 të NATO-s" për Shiritin e Ballkanit nderon anëtarët ushtarakë dhe civilët të cilët kryejnë shërbim në mbështetje të operacioneve të NATO-s në ose pas 1 janarit 2003 në rajonin e Ballkanit, duke përfshirë tokën dhe hapësirën ajrore në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni (Ish Jugosllavi). Për të qenë të kualifikuar, individët duhet të kenë kryer 30 ditë shërbim në këtë rajon, radhazi. Çmimet e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut nderojnë anëtarët e ushtrisë ndërkombëtare që kryejnë shërbim në emër të NATO-s, pra të forcave ushtarake aleate ndërkombëtare të angazhuara për të mbështetur njëri-tjetrin në rast konflikti.

Medalja e NATO-s u krijua për herë të parë në 1996 për të vlerësuar individët që kishin shërbyer në Forcën e Zbatimit (IFOR) si pjesë e Operacionit Përpjekje e Përbashkët në ish-Jugosllavi. Shiriti u krijua në



KFOR në Kosovë, ka nderuar me medaje, nënkolonel Arjan Rroshi, nënkolonel Lulzim Hoxha, kapitene Elisabeta Alcani dhe kapitene Anita Gruda



1999 për pjesëmarrësit në Operacionin Forca Aleate në Kosovë. Ndërsa operacionet e NATO-s u bënë më të zakonshme, shiritat të ndryshëm u krijuan për secilin operacion. Medalja përmban një trëndafil të qarkuar të përshtatur nga një kurorë dafinash. Shiritat janë blu dhe përgjysmohet nga një shirit i hollë vertikal argjendi, i rrethuar nga të dy anët, nga një shirit i hollë i bardhë.

"Moral Welfare Activities"

Përveç detyrave operacionale në kontributin e tyre në misionin e KFOR-it, nën autoritetin op-

eracional të Komandës të KFOR, ushtarakët ndërthurin detyrimet dhe përgjegjësitë kombëtare si ushtarakë të FA të RSH me aktivitetet dhe programet që kontribuojnë në mbajtjen, gatishmërinë dhe mirëqenien mendore, fizike dhe emocionale të personelit ushtarak. Pa u shmangur nga detyrimet direkte të misionit dhe angazhimet kombëtare, qofshin këto lidhur me detyrat që gjithësecili ka në FARSH, qofshin edhe ato sociale që janë DMD në një mision për të ruajtur gjendjen morale psikologjike e shëndetësore të kontigjentit.





QENDRA KULTURËS, MEDIAS, BOTIMEVE TË MBROJTJES DHE MUZEUT TË FA

Koncert festiv me rastin e 1 Qershorit

Ditën e martë, pasdite, në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës, Qendra Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut

të FA, institucion në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes organizoi një koncert me rastin e festës së 1 Qershorit. Pranë busteve të vëllezërve Frashëri fëmijët e

ushtarakëve realizuan një koncert për bashkëmoshatarët e tyre, prindërit dhe kalimtarët e shumtë të cilët u bënë pjesë e këtij programi. Të pranishëm për të ndjekur



Parku i
Liqenit të
Tiranës në
tingujt e
këngës dhe
ngjyrave të
pikturave,
realizuar nga
fëmijët e
ushtarakëve



aktivitetin ishin Zv.ministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, dhe drejtoresha e Qendres Kulturës, Medias, Borimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA, znj.Mirela Roshi. Ky

aktivitet muzikor është përgatitur nga Sektori i Aktiviteteve me drejtues z.Gazment Çaçi, regjizor Saimir Braho dhe artistët Redon Makashi dhe Kozma Dushi.

Fëmijët sollën një atmosferë të hareshme nën tingujt e zërave të tyre, por jo vetëm ata nën kujdesin e specialistes së pikturës Albina Ceka kishin realizuar punime mjaft të veçanta, të cilat në formën e një ekspozite të vogël i paraqiten për të gjithë të pranishmit.

Fëmijët ndjekin kurset e kantos, pianos, kitarës, pikturës dhe ky ishte momenti më i mirë dhe më i bukur për të treguar rezultatet e punës së tyre. Ata merituan çdo duartrokitje si të prindërve, që tregojnë se në çdo rast janë mbështetësit e tyre me besnik, por edhe të mësuesve të cilët ndihen krenar kur shikojnë se puna e tyre jep fryte të tilla.

Zv.ministria Bici në përshëndetjen e saj iu drejtua fëmijëve duke u thënë 'Unëshoh tek ju dritë, gëzim, shpresë dhe të ardhmen. Duhet ti bëni krenarë prindërit tuaj, gjyshërit dhe kjo arrihet duke u bërë edhe më të mirë duke pasur vetëm suksese në mësim, gjë për të cilën jam e bindur se ju do ti arrini. Ishte një kënaqësi dhe ju falënderoj për secilin emocion, që na dhuroat.' Në faqen e tij zyrtare në facebook është shprehur edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi duke thënë "Urimi i 1 qershorit nga fëmijët e talentuar të ushtarakëve për të gjithë bashkëmoshatarët e tyre. Gëzuar! "

Cirku, animatorët ishin të pranishëm për ti dhënë edhe më shumë ngjyra festës. Numrat e akrobacisë dhe humori shoqëruan shfaqjen gjatë gjithë kohës. Fëmijët meritojnë gjithë vëmendjen tone, janë e ardhmja e shoqërisë.

Vendim i Këshillit të Ministrave, datë 12 maj 2021

Edhe Ministria e Mbrojtjes kontrollon importin dhe tregtimin e armëve

“Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptare dhe të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në teritorin e Republikës së Shqipërisë”

Më datë 12 maj, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr.348, date 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptare dhe të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në teritorin e Republikës së Shqipërisë”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 7, të nenit 9, të ligjit nr.74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave ka vendosur në vendimin nr.348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto

ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, “Regjimi për hyrje/daljet dhe regjistrimin e armëve në teritorin e Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa: a) Shkronjat “a”, “c”, dhe “ç”, të pikës 2, ndryshohen, si më poshtë vijon: “a) Licencë për import dhe tregtim të armëve të kategorive “C” (gjahut), pjesëve kryesore dhe municionit të tyre të lëshuar nga Komisioni Qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose licencë për import/eksport, ndërmjetësim, transit, për armët e kategorive “B”, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre të lëshuar nga struktura përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes. c) Licencë të lëshuar nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, për import/ek-



sport të armëve të kategorisë "B", pjesëve kryesore dhe municionit të tyre. ç) Dokumentin e blerjes së armëve, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre. Armët regjistrohen me numra serialë, numrat serialë të pjesëve kryesore, tipin, kalibrin, modelin shtetin prodhues dhe fabrikën e prodhimit.". b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon: "6. Në rastet kur punonjësi i policisë kufitare, gjatë kontrollit fizik, gjen armë, pjesë të armëve dhe municion, të cilat subjekti i licencuar, person fizik ose juridik, nuk i ka në inventarin shoqërues autorizimit të importit ose ato janë armë dhe municione që nuk përfshihen në autorizimin e importit ose kanë numra të ndryshëm serialë nga ato në autorizim, punonjësi i policisë/doganës duhet të sekuestrojë armën dhe municionin. Ai njofton vendin e eksportit/importit që të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të ndryshojë autorizimin, duke përditësuar inventarin shoqërues ose të tërheqë armën, pjesën e armës ose municionin që nuk është në inventarin fizik shoqërues, pas kryerjes së veprimeve procedurale penale në shtetin e origjinës ose shtetet ku kanë kaluar transit. Armët, pjesët e armëve dhe municionet, të cilat nga kontrolli fizik rezultojnë se nuk kanë një numër serial, sekuestrohen nga autoritetet pas kryerjes së veprimeve procedurale penale të nevojshme nga punonjësi i policisë kufitare dhe tërhiqen më pas nga vendi i eksportit.".

2. Titulli i kreut të dytë ndryshohet dhe bëhet "Procedurat e markimit të armëve të zjarrit".

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: "9. Për kategorinë "B" dhe "C" të armëve dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë duhet të kenë të shënuar një markim të dukshëm, të përhershëm dhe unik. Markimi unik përfshin emrin e prodhuesit, ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë, vitin e prodhimit dhe modelin nëse nuk është pjesë e numrit të serisë. Markimi është detyrim i subjektit të licencuar për import/eksporti të

armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.".

4. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje: "9/1 Municionet e prodhuara dhe të importuara duhet të përmbajnë markimin e plotë në çdo pakoje (paketimi), në mënyrë që të tregojë vendin e prodhimit, emrin e prodhuesit, numrin e identifikimit të partisë (lotit), vitin e prodhimit, kalibrin dhe llojin e municioneve.".

5. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: "10. Markimi i armëve të zjarrit të kategorive "B" dhe "C" bëhet për armët e importuara nga të gjitha vendet me destinacion Shqipërinë, pavarësisht shënimit që kanë nga vendet e origjinës. Përfshihen nga kjo procedurë armët e importuara nga vendet e BE-së, mbi të cilat një shtet anëtar ka vendosur një markim.".

6. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon: "11. Markimi i armëve të zjarrit realizohet nëpërmjet shtypjes me shkronja e numra. Marka e Shqipërisë shënohet AL në një rreth me diametër 6 mm. Viti i importimit shënohet jashtë rrethit me madhësi 3mm. Thellësia minimale e brazdës bëhet me të paktën 0,1 mm nëse vendoset në një pjesë metalike, dhe të paktën 0,3 mm nëse realizohet në një pjesë polimer.".

7. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon: "12. Markimi vendoset në pjesën kryesore të dukshme të armës së zjarrit dhe në pjesët kryesore të armëve. Markimi duhet të jetë i pazëvendësueshëm në asnjë rrethanë.".

8. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon: "13. Subjektet e licencuara sipas shkronjës "a", të pikës 2, të këtij vendimi, janë përgjegjëse për markimin e armëve të zjarrit të kategorisë "B", të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë. Markimi i armëve të kategorisë "B" dhe pjesët kryesore realizohet në vendin e origjinës nga ku importohen dhe duhet të jetë në përputhje me standardet e

përcaktuara sipas pikave 11 dhe 12, të këtij vendimi. Standardet e përcaktuara sipas pikave 11 dhe 12, të këtij vendimi, kontrollohen në pikën e kalimit kufitar nga Policia e Shtetit. Armët që nuk përmbushin standardet e markimit sekuestrohen.".

9. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon: "14. Procedurat e markimit nuk aplikohen: a) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre të importuara nga vendet e BE-së, nëse nga shteti eksportues janë markuar; b) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat importohen ekskluzivisht për qëllime kërkimore. Në këtë rast armët markohen me inicialet "LB"; c) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat lëvizin transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë; ç) për armët e zjarrit të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore (armë zjarri antike).".

10. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon: "15. Procedurave të markimit u nënshtrohen edhe armët e zjarrit që çaktivizohen. Markimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre bëhet nga subjekte shtetërore të licencuara për çaktivizimin e armëve të zjarrit. Modeli i markimit unik të çaktivizimit është: EU(1) Aa(2) bb(3) c(4). (1): Vendoset në fillim të markimit për të gjitha vendet e BE-së; (2): Shteti që kryen çaktivizimin; (3): Simboli i strukturës që kryen çaktivizimin; (4): Viti kur është kryer çaktivizimi.".

11. Pika 16 shfuqizohet.

12. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon: "17. Armët e zjarrit të markuara sipas procedurave të pikës 15, të këtij vendimi, para se të jepen për përdorim kontrollohen nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit. Për të gjitha armët jepen certifikatat e markimit. Nuk lejohej të jepen për përdorim armët e zjarrit të pamarkuara." Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes dhe ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

Këshilli i Ministrave, datë 31 mars 2021 miratoi vendimin "për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar", ku indeksi, në masën 2.7 për qind, përfitojnë krahas kategorive të tjera edhe pensionet e caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji.

Përfitojnë familjet e pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, dhe nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar. Gjithashtu përfitojnë

edhe ata që kanë trajtime të veçanta financiare të caktuara sipas

Detarët që përfitojnë nga indeksi 2.7 % i pensioneve



ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënofficerë, lundruar të nëndetësve dhe polumarëve të Forcave Detare në pension".

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, brenda një muaji nga data e miratimit të vendimit, duhet të hartojë dhe të dërgojë për botim në

"Fletoren zyrtare" tabelën e koeficientëve progresivë të indeksimit të bazës së vlerësuar të arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura për periudhën kontributeve deri në vitin 2021, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2021.

Më datë 31 mars 2021, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin "Për përcaktimin e Stemës dhe të Flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes". Kjo u në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes". Me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e stemës dhe të flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi. Stema dhe flamuri deko-

Miratohet Stema dhe Flamuri i Agjencisë Inteligjencës së Mbrojtjes

rativ i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për nga qëllimi i përdorimit, i përkasin vetëm strukturës së kësaj agjencie. Ndalohet shumëfishimi, imitimi dhe përdorimi i tyre nga institucionet apo subjektet e tjera, që, sipas ligjit, përdorin uniforme. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".



“Objekti Nr.38” kalon me përdorim te Drejtoria e Arkivave

Këshilli i Ministrave, miratoi më 9 qershor 2021, vendimin “Për një ndryshim në vendimin Nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të komponentit “Objekti Nr.38”, pjesë përbërëse e pronës me numër rendor 1332, me emërtimin “Ish-Shtabi i Brigades”, pjesë e pasurisë 201/84, ndodhur në zonën kadastrale 8541, Gjirokastër”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e vijues, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave vendosi:

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e komponentit “Objekti nr.38”, pjesë përbërëse e pronës me numër rendor 1332, me emërtimin “Ish-Shtabi i Brigadës”, pjesë e pasurisë 201/84, ndodhur në zonën kadastrale 8541, Gjirokastër, ndryshohen sipas përmasave të përcaktuara në planrilevimin e planimetrit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 7-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes të Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për ushtrimin e



funksioneve administrative. Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të lidhin marrëveshje për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të pronës, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”

KËSHILLI I MINISTRAVE

Aeroporti “Nënë Tereza”, aeroport rezervë i Forcave të Armatosura

Më datë 2 qershor, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin “Për caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme”. Vendimi i mësipërm u morë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “i”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Mbi bazën e këtij ligji me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave, caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.



Digjitalizim! por ende nuk ka një program informatizimi

Fondi i bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura përmban 8.847 tituj (46.848 kopje), por për momentin ende nuk ka një program informatizimi

MSC Nafie Lala
Hajrie Dedaj

Si një vatër e dijes dhe kulturës, bibliotekat luajnë një rol themelor në shoqëri. Burimet dhe shërbimet që ato ofrojnë krijojnë mundësi për të mësuar, mbështesin shkrim-leximin dhe edukimin, ndihmojnë në formësimin e ideve dhe perspektivave të reja që janë thelbësore për një shoqëri krijuese dhe inovative. Bibliotekat janë sinonim i arsimit dhe ofrojnë mundësi të panumërta për të mësuar, mund të ushqejnë zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Libri është postieri i dijes në mendjen e gjithsecilit. Fjala 'fuqi' ka qenë e lidhur për një kohë të gjatë me forcën muskulore, kurse fjala 'njohuri' ka qenë gjithmonë e lidhur me mendjen. Dekadat e fundit fuqia botërore ka pësuar një transformim të jashtëzakonshëm. Nëse vite më parë forca treguhej në një fushëbetejë dhe më shumë rëndësi kishte forca fizike sesa ajo mendore, sot fuqia e penës është më e fortë se shpata.

Vendi ynë ka një trupë ushtarakësh, oficerësh, nënoficerësh punonjës civilë, që marrin shërbimin e nevojshëm pranë Bibliotekës së Akademisë të Forcave të Armatosura. Biblioteka e Akademisë që prej 10 majit të 1958 ka qenë pjesë e Akademisë Ushtarake. Në vitet e saj të para fondi i bibliotekës ishte kryesisht literaturë ushtarake mësimore, botime të Akademisë së ushtarakëve, leksione, dispensa metodike, plan seminarë, rregullore, manuale të Ministrisë së Mbrojtjes sigurisht edhe libra artistik. Biblioteka vijon të pasurohet me libra, botime periodike ushtarake

në gjuhë të huaj apo botime shkencore. Në vijim do të njiheni në vija të përgjithshme me mënyrën sesi është e organizuar, procesin e klasifikimit të librave, pasurimin e saj me literaturë, apo rrugën që biblioteka e Akademisë është duke bërë drejt digjitalizimit.

Fondi dhe rrugët e pasurimit të bibliotekës

Biblioteka pasurohet në mënyrë të vazhduar me literaturë, duke bërë të mundur që secili lexues të ketë mundësinë të ketë në dispozicion dhe të punojë me materialet që ai kërkon. Ajo pasurohet rregullisht me libra, botime të Tipografisë Ushtarake, botime nga shtëpitë botuese të ndryshme, blerje të literaturës së huaj në rusisht, anglisht, italisht, frëngjisht dhe serbo-kroatisht. Në 2006 fondi i bibliotekës numëronte 1400 tituj (7000 kopje), kurse sot fondi i bibliotekës përmban 8847 tituj (46848 kopje) nga të cilat: Fondi i literaturës

ushtarake 1000 tituj (14437 kopje); Fondi i literaturës shqip jo ushtarake 4657 tituj (21306 kopje); Fondi i literaturës në gjuhë të huaj 2860 tituj (7305 kopje); Fondi i periodikut (revista, gazeta, buletine) 30 tituj (2300 kopje), Fondi i leksioneve, disertacioneve dhe temat e studenteve master shkencor dhe profesional 300 tituj (1500 kopje).

Fondi i enciklopedive (britanike, franceze, italiane, ruse, greke, jugosllave etj.) të cilin e përmendim edhe si fondin më me vlerë, 23 tituj, fondi i bibliografive 10 tituj. Pasurimi me literaturë në bibliotekën e Akademisë realizohet disa herë gjatë 1 viti. Pasurimi është i përhershëm sidomos me literaturë ushtarake, botimet e akademikëve, botime të kërkimit shkencor në Akademinë e Forcave të Armatosura, botime të Ministrisë së Mbrojtjes, sigurisht dhe me blerjet që bëhen, por dhe me dhurata nga institucione siç ishin ato të Akademisë së Shkencave, ku në



tetor 2020 dhuroi 220 tituj, botime të saj. Para se të kalojë në dorën e lexuesit literatura përshkon një proces të gjatë të përpunimit sipas rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik dhe klasifikimit. Proceset janë: vulosja e çdo njësie bibliotekare, regjistrimi në librin e inventarit, skedimi i çdo titulli të literaturës, vendosja e etiketës me nr. e adresës në raft të çdo njësie dhe së fundmi, por jo më pak i rëndësishmi është klasifikimi (studimi nga ana shkencore) sipas KDU Klasifikimi Dhjetor Universal.

Klasifikimi i librit

Klasifikimi është akti i organizimit të universit të dijeve sipas një renditje sistematike. Klasifikimi ndihmon në gjetjen e vendndodhjes së materialit, ndihmon përdoruesin të mendojë për aspektet me të cilat ka lidhje kërkimi. Me anë të klasifikimit mundësohet dhënia e informacionit për më shumë se një subjekt të caktuar.

Seleksionimi kryhet duke u bazuar në ligjin për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë nr. 8576 datë 03.02.2000. Seleksionimi kryhet duke u bazuar në: gjendjen fizike të literaturës; vjetërsinë e materialeve; përmbajtjen; sasinë e kopjeve. Në të gjitha rastet ruhet "kopja arkiv". Ndodh që lexuesit të jenë të paqartë për informacionin që kërkojnë dhe për këtë arsye biblioteka ndërton mjetet e saj të kërkimit të informacionit siç janë:

Skedarët (katologët manual) janë një përmbledhje e skedave të cilat përveç përshkrimit bibliografik fizik përmbajnë edhe numrin e klasifikimit. Mbi bazën e numrit të klasifikimit vendosen edhe skedat në skedar ku përfshihen të gjitha fushat e dijës.

Digjitalizimi në Bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura

Fytyra e bibliotekave po ndryshon ndërsa përmbajtja po lëviz drejt një platforme digjitale dhe aksesit në internet po bëhet gjithnjë e më i madh. Tashmë është një domosdoshmëri njerëzore më shumë sesa një privilegj. Ndërsa interneti bëhet pjesë e jetës sonë, digjitalizimi mbetet një nga sfidat më të rëndësishme për bibliotekat në Shqipëri. Ka vite që po flitet për finalizimin e projektit të digjitalizimit në Bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe mbase një ditë ky finalizim do të arrihet. Me akreditimin nga Qeveria në mbledhjen datës 19 shkurt 2020, të Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm i arsimit të lartë ushtarak, edhe biblioteka e Akademisë së Forcave të Armatosura

merr një rëndësi edhe më të madhe me prioritet pasurimin me literaturë dhe informatizim në mënyrë që literatura të gjendet online me gjithë informacionin që ka biblioteka. Për momentin ende nuk ka një program informatizimi, dhe në momentin që do të vendoset ky i fundit çdo material i bibliotekës do të jetë online. Biblioteka digjitale do të shërbejë për të gjithë personelin ushtarak, apo civil qoftë ai, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, ku nëpërmjet internetit do të shërbehen disa kategori librash ushtarakë, filozofikë dhe artistikë. Sigurisht, që pas tyre do të gjenden online dokumentacione, udhëzime dhe direktiva. Është shumë e rëndësishme të digjitalizohen materialet me vlerë, që rrezikojnë të shkatërrohen fizikisht, pasi mund të jenë qindra vjeçare.

Informatizimi i bibliotekës mbetet ende një nga sfidat më të mëdha për bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura. Sipas ligjit nr. 8576 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë" çdo person ka të drejtën e marrjes së informacionit pa dallim moshe, gjinie, race, feje, bindjeje. Biblioteka e AFA-së i shërben jo vetëm AFA-së, por të gjithë Forcave të Ar-

matosura dhe më gjerë. Sipas rregullores së brendshme të bibliotekës shërbehet jashtë bibliotekës 1-3 njësi bibliotekare me kohëzgjatje nga 2-3 javë për librin shqip dhe deri një muaj për librin e huaj. Kopja e vetme dhe disertacionet nuk lejohen të dalë nga biblioteka, por shërbehen në sallat e leximit. Fotokopjimi i materialeve bibliotekare bazohet në rregulloren e bibliotekës.

Punonjësit e Bibliotekës së Akademisë janë trajnuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, sigurisht, që nga ana profesionale zhvillohen edhe shumë bashkëpunime e konferenca të përbashkëta. Biblioteka Kombëtare është ajo, që mbetet vendimmarrëse nga ana profesionale kundrejt gjithë bibliotekave të tjera në vend, pra edhe kundrejt Bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura. Tashmë hapësira e Bibliotekës së AFA-së ka një sipërfaqe prej 650 m², me dy salla fondesh, dy salla leximi me 25 vende, sallë interneti me 12 vende, sallë leksionesh. Biblioteka e Akademisë duke pasur një profil ushtarak mbetet streha e së kaluarës, e së tashmes dhe e së ardhmes për sa i përket kulturës ushtarake.

KËSHILLI I MINISTRAVE

Miratohet vendimi për aktivitetet ushtarake të NATO-s dhe Aleatëve

Qeveria në mbledhjet e vet të datës 22 qershor 2021, miratoi vendimin "Për miratimin në parim, të notës së aderimit/deklarimit të synimit, për tu bërë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të fuqive Aleate në Europë dhe shtabit të Komandës Supreme Aleate për transformimin, në lidhje me dhënin e mbështetjes së shtetit prites për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve të organizatës të Traktatit të Atlantikut verior". Vendimi është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi: Miratimin, në parim, të notës së aderimit/deklarimit të synimit, për t'u bërë pjesë në memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me dhënin e mbështetjes së shtetit prites për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë". Po kështu mbi bazën ligjore të mësipërme, qeveria "miratoi në parim, të notës së aderimit/deklarimit të synimit, për t'u bërë pjesë në memorandumin e mirëkuptimit (MoU), ndërmjet qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënin e mbështetjes së shtetit prites për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve/aktiviteteve të ngjashme ushtarake të NATO-s, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë".

Gjeopolitika dhe fuqia ushtarake shqiptare në penën e një koloneli

Refleksione mbi librin "Gjeopolitika dhe fuqia ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë" të kolonel Zeno Jahaj, të publikuar pak kohë më parë nga botimet "Dritëro"

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Shqipëria-aktor dhe faktor gjeopolitik

Një libër doktrinar mbi gjeopolitikën dhe fuqinë ushtarake sapo është publikuar nga botimet "Dritëro". Publikimet mbi gjeopolitikën, por dhe fuqinë ushtarake janë të rralla në vendin tonë. Dikur rrethet intelektuale, veçanërisht ato ushtarake "ngopeshin" me Karlo Zhan dhe publikime fragmentare mbi gjeopolitikën e fuqinë etj., si Rudolf Kjellen, (shkencëtar politik suedez), Friedrich Ratzel, (babai i Gjeopolitikës gjermane), Halford Mackinder studiuesit e sferës së Gjeopolitikës, pa e përdorur termin "Gjeopolitikë". Koha rrjedh dhe hedh në tregun e librit prurje me "bollëk", por vështirë se mund të ketë tituj që i referohen embrionit ku formatohen shtete, ide, platforma, doktrina, analizojnë në detaje historinë, çështje që flasin për versione, varjante, skenarë e deri tek konsekuencat. Autori Jahaj, i kultivuar deri në palcë si shërbëtor i kombit dhe atdheut, me të drejtë e njehson veten me ushtrinë dhe ka dashur që me pasion t'u shkojë logjikës gjeopolitike dhe fuqisë ushtarake deri në fund. Ai kërkon të shterrojë të pashtershmen duke u bërë njësh me realitetin, me historinë e kombit tonë, veçanërisht me proceset e pas luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, procese të cilat i merr, ngrë, peshon, analizon, depërton në të gjithë planetin dhe i vendos në balancën e historisë, duke shikuar kontekstin e ngjarjeve dhe zhvillimeve. Autori Jahaj është futur tek "buka dhe gjella" e historianit, në arkiv sipas mënyrës së tij depërtuese, mes

librash, të dhënash, burimeve të hapura të NATO-s, i ka "bluar" në mendjen e tij dhe e ka nxjerrë mendimin "të shoshur" për lexuesin, që mesa duket është i përzgjedhur për nga thellësia e mendimit, por edhe për lexuesin e gjerë që mund të ndriçohet për pjesë e pjesëza të historisë së pashkruar gjerësisht më parë, për Shqipërinë për periudhat e prezencës në "Traktatin e Varshavës", për dashuritë dhe ndarjet e saj me jugosllavët, sovjetikët, kinezët, për dimrat e vetmisë së madhe, duke shkelur "në rrugë të pashkelura", të vetëm përballë të mëdhenjve dhe fqinjëve, të pavendosi kur amerikanët shtrinë dorën më 1973-shin, pesë vjet pasi Mehmet Shehu kishte denoncuar Traktatin e Varshavës. Autori mes termave "gjeopolitikë", "gjeografi politike", "fuqi ushtarake" duket se gjendet në shtëpinë e vet, në lëmin e fushës dhe hapësirave të tij të studimit. Analiza është një copëz Shqipërie, por të duket se përhapet si në "hapësirën jetike" të Haushoferit duke i dhënë dimensionin që i takon një kombi me rrënjë, një shtet që ka çarë një shekull e pak mes kompleksiteteve të mëdha. Kolonel Zeno Jahaj me librin: "Gjeopolitika dhe fuqia ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë" u bën nder lexuesit dhe i fut në mendime përmes një analize mbështetur në fakte në 523 faqe, në gjatë krerë nga "Tej mëdyshjeve" deri tek falënderimi me "mirënjohje" të 109 personaliteteve (që për koicidencë korespondojnë me njëqindëntë vjet shtet shqiptar), që ka njohur dhe që kanë ndikuar, ndihmuar, bashkëpunuar kolonelin në karrierën e gjatë në institucionet ushtarake, por edhe të fushës së sigurisë, të diplomacisë nga viti 1973

deri më 2013, një shtetar serioz që ka punuar me seriozitet në dy kohë, në vitet kur thinjej rinia dhe në kohën kur thinjej djallëria për demokratizimin e gjithë jetës së vendit dhe për të ecur energjikisht për të kapur trenin europian. Kolonel Jahaj nuk e ka "ngrënë bukën kot" dhe nuk e ka lënë kohën të rrjedhë pa lënë gjurmë, ndërkohë që përvesh llërët për të mbushur gjithë aparatin e librit, redaktimin e korrektimin tenik e shkencor e deri në detaje për një libër që parashikohet t'i rezistojë fort kohës. Përvojën dhe mundin jetësor e ka derdhur në një libër që rrok dy sistemet në planin historik dhe aspektin e vendit dhe rolit si faktor dhe aktor gjeopolitik sado i vogël qoftë, por rreth pozicionit të favorshëm gjeopolitik u rrekën dhe morën në analizë në të majtë dhe në të djathtë të planetit, midis lindjes dhe perëndimit. Kështu në kreun e parë vijnë Rreziqet e kërcënimit strategjike, për një periudhë që bota e LLIB ja kishte lëshuar vendin "Luftës së Ftohtë", ku asnjë pale nuk ja mbante "të tërhiqte këmbëzën". Lexuesi futet natyrshëm në konceptet dhe mjedisin real gjeopolitik, lexon rreziqet e kërcënimit e perceptuara nga drejtuesit më të lartë politik të Shqipërisë komuniste, që vetëm emrin kish të tillë, të mundshme dhe të perceptuara, të shkruar sipas një stili të qetë dhe herë herë edhe me dufe labe sikur futesh në "stogonët" e historisë, që në fakt vendi përjetoi natyrshëm deri sa formoi identitetin mes të mëdhenjve, e megjithatë "çunakët", që zbritën fitimtarë nga lufta me nazifashistët i përballi me një mal problemesh që fituan dhe dështuan përmes një loje të madhe, që kishte filluar në Jaltë në gadishullin e Krimesë, Teheran, Podsdam dhe në të gjitha



fuqisë, me të cilat kërkojnë të mburren dhe t'u tregojnë brezave identitet të fuqisë intelektuale që prodhon shkolla, Akademi, Universitete, që "prodhojnë" lidera të sigurisë e mbrojtjes, të kohës së paqes dhe luftës. Kreu i tretë që i referohet "Burimeve të Fuqisë" së Shqipërisë në "Luftën e Ftohtë" evidentohen elementët e fuqisë si: gjeografia, popullsia, burimet natyrore, zhvillimin ekonomik, kapacitetin industrial e bujqësor, strukturat politike, lidhshimin, ideologjinë, karakterin, moralin kombëtar, diplomacinë, sistemin shoqëror etj. Këtu mbi të gjitha qëndron fuqia e vërtetë e një kombi që të gjithë elementët formësohen dhe sinergjojnë tek fuqia ushtarake

tavolinat e bisedimeve të mëdha, ku Shqipëria jonë e vogël dukej e zhdukej msi një varkë në valët e oqeanit gjeopolitik botëror. Edhe kru i dytë është fusha e autorit, si përfaqësues i brezit më të ri të diplomatëve ushtarakë të shekullit të ri, ndërkohë që analiza shkon për diplomacinë, botëkuptimin, filozofinë politike, formimin, diktatin dhe më tej akoma edhe për orientimin, bindjet në fokusin e aspiratave të drejtuesit-lider Enver Hoxhës si absolut i Shqipërisë, që për 41 vite është dora e fortë në mënyrën e vet të drejtimit të vendit që vjen në këtë libër në mbi pesëdhjetë faqe trajtim. "Lidhja e qerres" sipas mënyrës allashqiptarçe pati kapërcime, por dhe një periudhë plot të papritura mes "dashurive" dhe "urrejtjeve" në lavjerrësin politiko-diplomatik të kohës.

Fuqia ushtarake, e frikshme për t'u rrekur, fusha e guximtarëve

Me "fuqinë ushtarake" janë të rrallë ata që depërtojnë përtej "perdes" që ka vulën "TSRV"/Tepër sekret e rëndësisë së vecantë. Është fusha e specialistëve e "llogaritarëve" të potencialeve njerëzore, monetare, mjeteve luftarake, armëve në tokë, det dhe ajër dhe kolonel Jahaj këtë e ka për zemër, të futet, të rreket, të analizojë, të triblojë përmes dokumenteve, të injorëjë tabelacionet, që janë kaq evidente në këtë fushë. Studuesit fillestarë futen direkt në "thela", hartojnë tabela, bëjnë krahasimet, ndërkohë që janë sekrete dhe të padukshme shumë probleme që lidhen me fuqinë. Ka dokumente që nuk çkyçen kurrë, sikurse ka edhe dokumentacion që koha i vjetëron dhe i nxjerr në shesh sekretet e së djeshmes. Ka shtete që ruajnë si të paprekshme element të



rake e shtetit, ajo fuqi që "thirret në skenë" në kohë luftë por edhe në kohë paqe kur populli përballë çdo rreziku thërret "ushtrinë" dhe "Zotin" për ndihmë dhe kjo është e vërtetuar në qindra raste, kur ka faktorë ekstremë të natyrës dhe jo vetëm. Sinergia e gjithë elementëve përkthehet në fuqi ose pafuqi përballë rreziqeve, ndërkohë që me të drejtë autori shprehet se, "Fuqia ushtarake buron nga fuqia kombëtare". Dhe më tej vendosja në peshoren e madhe të historisë të fuqisë kombëtare duhet të depërtosh thellësisht në elementët e ndërvartësisë, në "botën" e masave dhe të peshave, në një botë që asgjë nuk ka të dhënë një herë e përgjithmonë, pavarësisht se këto element nuk ka aparat që t'i matë ekzakhtësisht. Por e tillë ka qenë "Lufta

e Ftohtë", një term i çuditshëm, hua-zuar prej shkrimtarit anglez, Xhorxh Oruell, më 1945, kur "superfuqitë do binin dakord që të mos e "shkrepin" bombën atomike kundër njeri-tjetrit", por të ishte si një "mjet frikësimi në Luftën e Ftohtë". Më hapur do të shkruante Bernard Baruh, më 1947, "të mos mashtrohemi, ne jemi sot në mes të një Luftë të Ftohtë". Në një detajim shifrash me gjuhën e tyre vijnë në libër të dhëna krahasuese dhe të qënësishme përmes gojës së lidhshimit shqiptar, por edhe të dhëna krahasuese me europianët dhe amerikanët, me produktet e prodhimit dhe deri në Shqipërinë e "mbajtjes së frymës gjallë", në fund të mandatit gjysëm-shekullor të fitimtarëve të LLIB. Autori eksploron i lirë nacionalizmat dhe ishullorët, fuqinë e shteteve dhe kombeve, eksperiencat, fitoret dhe dështimet si rezultat i kësaj fuqie të ndryshueshme, sjell shembuj historie dhe depërton nëpër perandori e sultanate. Por sigurisht ndalet tek shqiptarët, "kjo kastë luftëtare e ballkanit", e mëkuar me shpirt mikpritës, kur maksima popullore ka marrë dhenë: "shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut", pavarësisht shpresave të shumta dhe zhgënjimeve, sepse "komunizmi nuk përputhej me natyrën dhe traditën e jetës së shqiptarëve", shprehet autori. Koha provoi se rregjimi totalitar nuk e bëri dhe nuk e radhiti vendin në një shtet të fortë, sepse "forca" dhe "shtrëngimi" nuk ishin bindje e vullnetshme, e ndërgjegjshme. Muret e ngritura me perëndimin e veçuan nga ekonomia botërore dhe sikurse thotë Erik Hobsbaum tek "Epoka e Ekstremeve", "...Shqipëria do të kthehej në një piri rrënojash ekonomike". Kapacitetet institucionale të shtetit nuk mund të perceptohen pa faktet krahasuese se, më 1938 vendi kishte 56300 nxënës ndërkohë që më 1983 kishte 713600 nxënës e student; mësues nga 1500 kishte 40000; shtrëtar spitali nga 800 arriti në 18100; nga 1 mijë për 8000 banorë arriti në 1 mijë për 583 banorë. Faktet flasin qartë për ngritjen por në raport me fqinjët europianët e më gjerë flasin për pamjaftueshmërinë e "fuqisë", që të qenë realitet i së ardhmes. Dhe kohët e provuan pamundësinë e vijimësisë, sepse rruga e zgjedhur ishte e gabuar.

Strategjia dhe doktrinat ushtarake një amalgam

Kreu i katërt në lidhje me strategjinë ushtarake, operacionet, luftimin, strukturën organizative, arsimimin, stërvitjen e gatishmerinë luftarake të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në vitet 1944-1992 përfshin gjithë aktivitetin ushtarak gjysëmshkullor. Autori të çon në "burimet" e strukturës së koncepteve, në ngritjen e një

ushtrie të "tipit të ri", duke harruar gjithçka kishte bërë më parë Shqipëria e viteve 1912-1939. Shtrati ideologjik dhe politik ishte përcaktues për këtë format të ri, në politikë, strategji, koncepte, parime, dhe në gjithë ngrehinën ushtarake shqiptare të gjysëmshekulit, në diktimin e rrethanave për të ulur numrin e formacioneve ushtarake partizane që zbritën nga 70 mijë, në 45 mijë e më tej në 35 mijë, por deri edhe në 27 mijë që ka qenë numri më i reduktuar ushtarak në gjysëm shekulli sepse pas vitit 1960 ushtria sërish u rrit aq shumë sa u kthye në një barrë të rëndë për ekonominë. Buxheti ushtarak i mbrojtjes "kafshonte" rëndë bushetin e shtetit të dobët shqiptar, sit ë ishte gjithmonë një "buxhet lufte". Kështu për periudhën e Luftës së Ftohtë, në vitet 70 dhe 80, ushtria shqiptare arriti në 61000 forca aktive, dhe 260000 rezerviste dhe një numër i madh i FVVP dhe RSHA, një organizuan disa herë në njësi të përmasave dhe formave joeficiente. Në fund të viteve 80-të ushtria kishte 22 divizione që përbënin 3 fronte, që bazohej në "konceptin e mbrojtjes pëllëmbë për pëllëmbë", duke e shpërndarë më tej atë nga 1500 shkoi në 2200 pika hapje në të gjithë vendin. Kështu ushtria kishte dalë jashtë kazermës dhe ishte bërë "pronë e popullit ushtar", ku nga ana tjetër fortifikimi u kthye në qëllim më vetë, duke ju dhënë detyrime massive ekonomive të drobitura shtetërore dhe kooperativave bujqësore si detyrime për mbrojtjen. Arsimimi ishte një ndër rrugët e reja dhe të mira të atij sistemi, që krijoi në fakt nëntë shkolla ushtarake dhe policore, por që kishte "harruar" elementin lidhës të ushtarait dhe oficerit duke mënjanuar plotësisht nga stërvitja hallën esenciale të nënoficerit të stërvitjes, dhe palcën e luftimit taktik. Shpejtësisë së veprimeve në fillim të veprimeve luftarake i kushtohej mjaft vëmendje për zjarren kundrajorë për 2-3 minuta, për batalionet mitraliere në 25-27 minuta, për efijensën e 25 -27 mitralozave të rëndë për çdo batalion artmitralier, për artilerinë tokësore të gatshme për zjarr për 10-20 minuta, për tanket që shkëputeshin nga rajonet e dislokimit për 10-20 minuta, për gatishmërinë e FLD dhe FLA, për kompletimin rezervist për 72 orë dhe për 700000 forca të rreshtuara gati për luftë në rast të një agresioni të armatosur. Të gjitha këto sa përmblohdhëm i shërbenin "Fuqisë Ushtarake" të vendit që vijnë nga autori në kreun e pestë ku me detajohet buxheti i mbrojtjes, fuqia njerezore, disiplina, moralin luftarak, armatimin, teknika, teknologjia, sasia dhe cilësia, fortifikimi, logjistika, zbulimi ushtarak, lidhshipi politiko-ushatarak për gjithë periudhën e "Luftës së Ftohtë", dhe që lidhshipi botëror nuk e lejoi në fakt që të kthehej në "luftë të nxehtë". Shqipëria ishte një copëz në oqanin e madh të përbindshave botërore të superarmatosur, që do të

matej me "një apo kualicion armiqsh" me NATO-n dhe me Traktatin e Varshavës, një përlogaritje paksa fluturake, ndërkohë që amerikanët Rash më 1973, tregoi gatishmërinë e SHBA-së për marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë. Dorës së shtrirë të amerikanëve dhe të gjermanëve në vitet '80-të do t'ju përgjigjeshim me dorë të rudhur ndërkohë që treni evropian vijonte të ecte me shpejtësi përpara. Kur shqiptarët u bënë njësh me erën demokratike të viteve '90-të treni evropian kishte ecur shupë përpara dhe duhej kohë energji, vullnet e dëshirë politikanësh që jo gjithmonë ka qenë në anën e duhur të historisë në këtë tridhjetëvjeçar. Ndërkohë që gjeopolitika botërore determinohej nga dy të mëdhenjtë Amerikanët e Sovjetikët, pas viteve '90-të është më se e natyrshme se në masë të madhe nga SHBA-ja si superfuqia e vetme botërore që udhëheq Rëndin e Ri Botëror, që mundi dhe shkërmoqi rusët në ekonomi, që mbetet lidere dhe promotore e lirive njerëzore, atyre ekonomike dhe procesit të globalizimit. Aktualisht po të kthesh vështrimin në tetë dekadat e fundit dhe të analizosh të tashmen shihet qartë fuqia e një kombi vital e amerikanëve që kanë një forcë me më shumë se 3 milionë efektive, 4800 baza ushtarake në shtatë kontinente dhe një buxhet vjetor më të madh se 700 miliardë dollarë, ushtria e Shteteve të Bashkuara konsiderohet si forca luftarake më e madhe e botës, fuqi që do të lozë rolin e saj në gjithë shekullin XXI. Duke parë këto shifra kushdo nga specialistët mund ta bëjë analizën në këndshikimet e fushave të interesit, përfshi edhe atë gjeopolitik dhe të fuqisë ushtarake.

Dilema e konstatimeve historike: Me NATO-n apo me Traktatin e Varshavës?!

Si historian, gjeopolitikan e analist kolonel Jahaj në kreun e fundit trajton burimet e arkivave të NATO-s, ku vërtetohet se Shqipëria ka qenë pjesë integrale e axhendës së analizës, vlerësimit dhe parashikimit ushtarak e politik të NATO-s, të SHBA-ve si dhe të vendeve të tjera fqinjë dhe më gjerë. Shqipëria dhe Republika Demokratike Gjermane, do përbënin një rast të dyshimtë në Traktatin e Varshavës, prandaj dhe qëndrimi ndaj Shqipërisë të të dy pakteve më të mëdha ushtarake të globit përgjatë Luftës së Ftohtë vështrimi është vetëm bazuar në dokumenta autentike arkivore ku kolonel Jahaj analizon dy blloqet e mëdha në Luftën e Ftohtë, NATO-n e Perëndimit dhe Traktatin e Varshavës të Lindjes. Këtu ka dritëshikim të veçantë për SHBA-të dhe ish-Bashkimin Sovjetik, vendet rreth nesh si Italia, Greqia, Jugosllavia, Turqia, Bullgaria e më gjerë. Këtu vjen edhe analiza e fuqisë së vërtetë ushtarake të Shqipërisë në peri-

udhën e Luftës së Ftohtë, analizon Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun dhe gjithë udhëheqjen shqiptare të kohës, që vendosën gjithçka për Shqipërinë e periudhës së Luftës së Ftohtë (1945-1990), kur drejtonin "me dorë të hekurt", sipas bindjes e gjykimit të "komunizmit të tipit të shqiptarizuar". Autori ndalet gjatë tek fuqia ushtarake e vendit dhe ekonomia e saj që mbante në këmbë një makineri të madhe e të rëndë ushtarake, një force ushtarake me armatim, teknikë e teknologjia ushtarake të vjetëruar, që realisht nuk mund ti përgjigjej kohës, sepse mbahej gjallë një tenikë që bota kishte një cerek shekulli që e kishte hedhur dhe kishte future teknologji të re. Është i drejtë konstatimi se, "arsenali luftarak shqiptar nuk i shërbente më Fuqisë Ushtarake dhe ishte kthyer në të vërtetë një barrë e rëndë për ushtrinë e tipit të ri që synonte NATO-n dhe aderimin në strukturat evropiane. Me të drejtë në libër vjen një analizë se me kë do të ishte Shqipëria në rastin e një lufte të nxehtë. "Me NATO-n apo me Traktatin e Varshavës?", dhe kjo analizë është një thirrje për të tjerë studiues të fushës e kryesisht të spektrit ushtarak që kanë se çfarë të flasin për aktorë e faktorë, mjedisin, sistemin, ideologjinë, fuqinë, lidhshipin, qëndrueshmërinë e mbrojtjes, avantazhet e disavantazhet, për skenarët gjeopolitikë, për besimin e verbër, institucionet ushtarake, për shkollat dhe akademitë, për jetën dhe psikologjinë e kohës e qindra derivate të tjera të jetës, të jetës së jetuar nga shqiptarët të ndershëm që besuan dhe qëndruan, që nuk besuan dhe ikën, që jetën e mbushëm me përkushtim, por edhe për rata që pësuan zhgënjim. Fjala e tyre vlen si pasuri e vlerave kulturore shqiptare, e thënë troç, në mënyrën e tyre, në gjykimin e tyre, si guximtarë të një kohe që e jetuan. Libri nuk është një stoli për bibliotekën për një vlerë e kohës. Por kolonel Jahaj ka lënë një shteg të hapur për studiues të spektrit të gjerë ushtarakë, gjeopolitikë e më gjerë, një rrugë të celur për ta thënë fjalën e vet, për t'u shprehur duke derdhur në letër "arkivën lëvizëse", pse jo të sjellin risitë shqiptare për gjeopolitikën dhe fuqinë ushtarake e më gjerë. Në një plan më të gjerë libri është një ftesë për intelektualët e fushës së letrave që ta thonë fjalën e vet për strategjinë, doktrinën, fuqinë, armatimet, fortifikimet, shprest e zhgënjimet, kapacitetet institucionale të shtetit, për kohët "teper sekret", aktualisht e deklasifikuar. Studjuesit e "vjetër" dhe të rinj pavarësisht nga format përbashkohen në përfundimin se, Gjeopolitika ka ekzistuar, pa u "zbuluar" si teori dhe shkollë, ekziston e do të vijojë të ekzistojë në epokën e globalizimit, në të përditshmen dhe në të ardhmen si dhe publikimi është një destinacion dhe mision për debat në këtë fushë me rëndësi që sigurisht kërkon guxim dhe fokusim në interesat kombëtare

shqiptare, i destinuar të mbijetojë dhe të zërë vendin e merituar ndërmjet kombeve të tjerë. Në vijimësi lexuesi do të ketë uri për thellim në analizën e periudhës së "perdes së hekurt", "luftës së ftohtë", vijat e mbrojtjes së NATO-s e Traktatit të Varshavës dhe se "pse Shqipëria mbeti në një brez shtetesh përkëtej perdes së hekurt, në një brez që Traktati i Varshavës as nuk e mbron, as nuk e sulmon Shqipërinë, pa u përplasur paraprakisht me NATO-n, etj. Në fund libri mbyllet me një "mirënjohje", si shenjë kaloresiake për disa nga personalitetet që autori e gjykon të arsyeshme në karrierën e gjatë të udhëtimit ushtarak dhe diplomatik.

Johan Wolfgang Gëte:
"Jetova aq sa punova!"
Dija si fuqi e potencial
i njerëzimit

Zeno Jahaj vjen prej një treve kaone me rrënjë labe të shquar historikisht për trimëri dhe mençuri, që u'a mëkon natyra dhe ambjenti familjar që kur përkunden në djepin e nënës. Ai është lindur më 5 shkurt 1952 në Mesaplik të Vlorës. Familja e tij është e njohur në zonën e Lumit të Vlorës (Mesaplik) për tradita patriotike dhe bujari. Rrugën e dijes e nisi në shkollën fillore të Mesaplikut, ndërkohë që klasën e pestë dhe të gjashtë të sistemit shtatëvjeçar i kreu në Bolenën e trimërive. Klasën e shtatë e përfundoi në Bishan të Vlorës, duke bërë që rrethi i bashkënxënësve dhe të njohurve të ishte mjaft i gjerë. Pas përfundimit të shkollës 7 vjeçare në Mesaplik, në vitet 1966-1970 u përzgjedh për të vijuar shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Më pas ndoqi studimet në vitet 1970-1972 në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, si dhe kurs për zbulimin ushtarak. Në të gjitha nivelet e arsimimit si dhe në të gjitha lëndët mësimore ka arritur rezultate të spikatura. Ndërkohë që gjatë studimeve në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve është vlerësuar me medalje të artë dhe bente pjesë në studentët elitarë të shkollës. Nga Shtatori i vitit 1972 deri në Qershor të vitit 1973 kreu Kursin e Zbulimit Ushtarak Gjitharmësh pranë Regjimentit të Zbulimit (ish-Detashmenti i Zbulimit), në Zall-Herr, Tiranë. Në vijimësi ka kryer detyrën komandant toge e pastaj instruktor rinie e kulture po në atë njësi, ndërkohë që për periudhën 1976 deri në vitin 1984 kreu detyrën e instruktorit të përgatitjes së zjarrit dhe komandant kompanie në Shkollën Ushtarake të Oficerëve Rezervistë në Zall-Herr. Ka qenë një prej instruktorëve elitarë me përgatitje të lartë profesionale dhe me ambicje të lartë, duke sakrifikuar shumë nga vetja pa njohur orar, si dhe i lidhur fuqishëm me librat, me të renë dhe progresiven që

aplikohej në atë periudhë në ushtri e veçanërisht në shkollat ushtarake. Nga viti 1984 deri më 1992 kreu detyrën oficer shtabi, instruktor stërvitjeje në Drejtorinë e Përgatitjes Luftarake në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, detyrë që përthithte plotësisht me meritokraci më të mirët e ushtrisë së ataj periudhe. Brenda kësaj kohe, në vitet 1987-1988, pajiset me dije të arsimimit të lartë ushtarak gjitharmësh në Akademinë Ushtarake. Pas rivendosjes së gradave ushtarake më 28 Nëntor 1991 j'u dha grada ushtarake "Nënkolonel", bazuar në vjetërsinë e shërbimit në Forcat e Armatosura. Si shumë oficer të aftë dhe profesionale, për "shkak të reformës ushtarake" në vitin 1992 lirohet nga statusi i oficerit të shërbimit aktiv në statusin e oficerit në rezervë, por pas pesë vitesh më 1997 thirret për të rivijuar me statusin e oficerit të shërbimit aktiv dhe emërohet oficer shtabi në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Në vitin 1997 falë aftësive të tij gjuhësore dhe profesionale shkon në Romë ku kryen kursin e Lartë në Kolegjin e NATO-s. Duke qenë se studimet dhe marrëdhëniet e ngushta me librin, bibliotekat, arkivat i ka pasur që në rininë e tij të herdhme shumë të mira në vitet 2011-2013 ka ndjekur studimet për master në Sigurinë Kombëtare në Akademinë e Mbrojtjes (sot AFA), ku ka shkëlqyer me performancën studentore në rangun e një pedagogu. Mjaft kërkues ndaj vetes dhe shumë i angazhuar në diskutime të nivelit të lartë për çështjet e strategjisë, gjeopolitikës, sigurisë kombëtare e ndërkombëtare, një analist i spikatur i situatave botërore, ka bërë që të vihet në udhëheqje të grupeve të punës dhe debateve për nivele dhe çështje nga më të mpreshtat të sigurisë. Pas përfundimit të Kolegjit të NATO-s në Romë, në vitet 1998-2003, ka kryer detyrën "Atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Greqisë", këshilltar diplomatik, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Greqisë. Në këtë mision, pesë vjeçar punoi nën ministrat e mbrojtjes Sabit Brokaj, Luan Hajdaraga, Ilir Gjoni, Luan Rama, Ismail Lleshi e Pandeli Majko, dhe me ambasadorët e karrierës Kasriot Robo e Bashkim Zeneli. Në vitet 2003-2008 ka kryer detyrën e shefit të kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Lejtnant Pëllumb Qazimi dhe në vitet 2008-2010 ka qenë këshilltar ushtarak i Ministrit të Mbrojtjes me gradën madhore ushtarake "Kolonel". Gjatë kësaj kohe kam kryer kurse të shkurtëra në fusha të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit (SHBA). Pasioni për librat, për shkollat, për diturinë e bëjnë të veçantë dhe të spikatur në analiza të ftohta dhe me gjykim të thellë. Edhe kur ka qenë në nivel profesori e quante veten student dhe matej me realitetin

ndryshe, edhe kur ndiqte gjithë durim nivelin "Master shkencor" në fushën e sigurisë në AFA ishte një vëzhgues i hollë i realiteteve. Debatet në auditor dhe jashtë auditorëve kishin shije, "kripë dhe lezet", për thellësinë dhe gjerësinë e mendimit të kualifikuar të armatosur me përvojë të gjatë akademike, shkencore, ushtarake e diplomatike. Në vitin 2008 nxirret në rezervë, por prej vitit 2008 deri në vitin 2010 ka qenë Këshilltar i Ministrit të Mbrojtjes. Ndërsa nga viti 2010 deri në vitin 2013 kreu detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Përkujdesjes Sociale dhe specialistit të lartë në strukturat e politikave dhe planifikimit strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 2013 kalon në statusin e pensionit të parakohshëm dhe në vitin 2017 në statusin e pensionit të plotë, edhe pse gjatë këtyre viteve angazhohet në një kompani private të sigurisë fizike, duke kryer vlerësime të rrezikut të sigurisë për objekte të rëndësishme strategjike në Shqipëri. Përmes arsimimeve institucionale dhe vetëstudimit, kam përvetësuar dhe përdorur gjerësisht gjuhët angleze, italiane dhe greke. Ai ka shkruar, përkthyer e botuar libra të fushave gjeopolitike e ushtarake si: "Gjeopolitika dhe Fuqia Ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë", "Psikologjia e Lidershipit në Ushtri", e të tjera, si dhe ka publikuar rregullisht, në gazeta e revista të vendit e të huaja, artikuj të fushave gjeopolitike, ushtarake, sigurisë kombëtare, marrëdhënieve ndërkombëtare, etj. Ai është i martuar me zonjën Fatbardha Jahaj (Thanasi), e cila ka punuar në strukturat e radiozbulimit, në Ambasadën e RSH-së në Athinë, në Arkivin Qëndror të Forcave të Armatosura. Kanë dy djem të rritur Melsi dhe Elvi, si dhe është një familjar i përkushtuar. Faktikisht puna e kolonel Jahaj nuk është ndalur asnjëherë dhe nuk njih pushim, sepse është i lindur për punë e përkushtim sepse i dituri dhe puntori devizën e jetës e lexojnë tek Johan Wolfgang Gëte: "Jetova aq sa punova". Si një lexues i apasionuar Zeno Jahaj do të shkonte për shtat shprehja proverbiale e Ivan Turgeniev: "Natyra nuk është një tempull, por një punishte, ku njeriu e ka vendin si punëtor". Dhe në fakt Zeno Jahaj e ka parë dhe e ka sprovuar veten në një jetë plot përkushtim duke shkëlqyer në të gjithë drejtimit, në arsimim, në punë, në detyra e funksione të ulëta e të larta, në diplomacinë ushtarake e më gjerë si njeri i aksionit dhe që udhëhiqte vazhdimisht me shembullin personal dhe dijen e ka parë gjithmonë si fuqi dhe pushtet. Me siguri në të ardhmen e afërt do të shkojë përtej gjeopolitikës dhe fuqisë ushtarake dhe do të shpallë para intelektualizmit ushtarak dhe jo vetëm palcën e atdhetarisë ushtarake dhe më gjerë, përjetimet e kohës së një paqeje të brishtë nën një rregjim gjysëmshkullor, por dhe përjetime demokratike përtej tre dekadave.



Regjimenti i Parë i Këmbëtorisë së Forcave Tokësore

Mehaj: Ju treguat performancë të shkëlqyer në “Defender-Europe 21”

Regjimenti i Parë i Këmbëtorisë përfundoi stërvitjen fushore në kuadër të Stërvitjes së Forcave ushtarake Amerikane me forcat aleate “Defender-Europe 21”

Për vlerësimin e lartë dhe përgëzimin për performancën e shkëlqyeshme, ministri i Mbrojtjes, Arment Mehaj, i shoqëruar nga zv. ministri i Mbrojtjes Shemsi Syla, vizitoi më 15 qershor 2021, kazermën e FSK-së në Gjilan, respektivisht Regjimentin e Parë të Këmbëtorisë së Forcave Tokësore. Pas takimit me stafin komandues dhe shtabor të Regjimentit, prirë nga nënkolonel Albert Kuçi, ai iu drejtua të gjithë pjesëtarëve të kësaj njësie, e cila përfundoi me sukses të lartë stërvitjen e saj fushore në kuadër të Stërvitjes së Forcave ushtarake Amerikane me forcat aleate “Defender-Europe 21”. Me këtë rast, ministri Mehaj, para ushtarakëve, shprehu vlerësimin dhe mirënjohjen e lartë për performancën e shkëlqyeshme të tyre në stërvitjen “Defender-Europe 21” duke theksuar se me këtë

sukses keni dëshmuar praktikisht se keni arritur cilësinë e duhur për validimin e aftësive dhe kapaciteteve të para operacionale në nivel kompanie për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial. “Kjo e arritur është e veçantë duke pasur parasysh ngjarjen historike, kur vendi ynë ishte edhe vend pritës në kuadër të operacionit më të madh stërvitor të forcave amerikane me forcat aleate në rajonin tone”, -tha ministri Mehaj.

Ai gjithashtu, njoftoi me angazhimet dhe hapat e deritanishëm të Qeverisë në përgjithësi dhe Ministrisë në veçanti, në funksion të zhvillimit dhe avancimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale të nevojshme, bazuar në prioritetet e Qeverisë dhe qëllimeve strategjike të tij, me

orientim kryesor në profesionalizim dhe modernizim të forcave për ndërveprueshmëri të plotë dhe zgjerim të gamës së operacioneve jashtë vendit përkrah forcave amerikane dhe aleatëve tjerë. Ai u zotua se të gjitha angazhimet e tyre stërvitore e operacionale do të kenë mbështetjen e tij të plotë dhe se, si ushtarak do të ketë me prioritet mirëqenien e ushtarakëve, pajisjen, stërvitjen dhe specializimet adekuate të tyre për shërbim të bazuar në standardet dhe vlerat më të larta të ushtrive të vendeve të NATO-s. Më pas, ministri me delegacionin e tij dhe stafin komandues të regjimentit, bënë homazh në Memorialin Përkujtimor të Gjilan, ku nderoi veprën dhe sakrificën e të gjithë heronjve dhe dëshmorëve të kombit në këtë ditë që përkon edhe me Ditën e Çlirimit të Gjilanit me rrethinë.



Diplomohen mjekët e parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Turqi

Në Universitetin e Shkencave Mjekësore, gjegjësisht në Fakultetin e Mjekësisë Gülhane, u mbajt ceremonia solemne e diplomimit, ku në mesin e 112 studentëve, u diplomuan edhe katër kadetë të FSK-së, të cilët pas gjashtë vitesh studimesh morën titullin Doktor i Përgjithshëm si dhe gradën ushtarake Nëntoger. I pranishëm në ceremoni ishte edhe Atasheu i Mbrojtjes në Ankara, kolonel Bekim Osmani, i cili në emër të ministrit të Mbrojtjes z. Armend Mehaj dhe të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi dhe i shprehu mirënjohjen e lartë Rektorit të Universitetit të Shkencave Mjekësore për mbështetjen



që ky institucion ka dhënë dhe vazhdon të japë për FSK-në. Me këtë sukses, FSK-së i shtohen kapacitetet profesionale mjekësore

ushtarake në procesin e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme të mbështetjes operacionale.

KAZERMA "SKËNDERBEU", FERIZAJ

Gjermanët dhurojnë donacione me vlerë 210 mijë euro për FSK-në

Në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, u mbajt ceremonia e prezantimit të donacionit të qeverisë gjermane dhuruar për FSK-në. Në ceremoninë përkatëse, ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, ku u pritën nga komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu. Në ceremoni të pranishëm ishin edhe zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Jörg Rüter, komandanti i Komandës së Logjistikës, gjeneral brigade Naim Haziri dhe atasheu gjerman i mbrojtjes për Kosovën, nënkolonel Kai-Uwe Napel. Me këtë rast, ministri Mehaj falënderoi

qeverinë gjermane për donacionin përkatës duke vlerësuar dhe shprehur mirënjohjen e thellë edhe për gjithë mbështetjen e deritashme në të gjitha fushat për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Ai theksoi se bashkëpunimi me Gjermaninë si një ndër partnerët kryesor në nivel të ministrive të mbrojtjes dhe forcave të dy vendeve do të rritet edhe më tej në fushat e interesit të përbashkët. Nga ana e tij, ambasadori Rohde, shprehu kënaqësinë e tij që në emër të qeverisë gjermane dhuron donacionin përkatës duke theksuar se bashkëpunimi në mes dy ministrive do të thellohet edhe më tej si dhe mbështetja nga shteti gjerman do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në fund nga ana e gjeneral Spahiut dhe nënkolonel Napel

u ndanë certifikatat për personelin e specializuar për sistemin e frenimit të automjeteve të FSK-së. Donacioni përkatës përmban laboratorin e gjuhës gjermane dhe sistemin e frenimit të automjeteve si dhe trajnimin dhe certifikimin e personelit për këtë sistem me vlerën e përgjithshme prej 210 mijë euro. Kursi në gjuhën gjermane, që zhvillohet prej vitit 2017, me këtë laborator prej tani do të zhvillohet në kushte bashkëkohore dhe do të mundësojë përgatitjen më të efektshme të stafit gjermanisht-folës të FSK-së. Gjithashtu pajisjet e sistemit të frenimit do të mundësojnë flotë të sigurt dhe efektive të automjeteve të FSK-së.



Ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj priti në takim Këshilltarin e Transformimit të Mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor, gjeneral brigade Johnny Bowron. Me këtë rast, gjeneral Bowron, uroi ministrin Mehaj për detyrën duke vlerësuar të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe vizionin e tij për të ardhmen. Në takim, ministri Mehaj e njoftoi brigadierin Bowron me zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK, si dhe të arriturat e deritashme përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Ai, ndër të tjera shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për kontributin e madh të Mbretërisë së Bashkuar në ndërtimin dhe zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjeneral Bowron, më pas u prit edhe nga komandanti i FSK-së, gjeneralletjenant Rahman Rama, i cili theksoi se partneriteti me Forcat e Armatosura Britanike do të vazhdojë të jetë i fuqishëm në vazhdimësi për të arritur aftësitë, kapacitetet dhe standardet më të larta operacionale të FSK-së për përmbushjen e misionit të saj. Nga ana e tij, gjeneral Bowron shprehu gatishmërinë e Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme për këtë proces edhe në të ardhmen.

Ndërkohë para pak ditësh në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes,



Partneriteti me Forcat e Armatosura Britanike do të vazhdojë

Para pak ditësh në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuar nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar përfaqësuar nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mbrojtjes në zbatimin e reformave në proceset e tij të prokurimit për të siguruar ofrim të mirë-menaxhuar dhe efikas të shërbimeve publike.

përfaqësuar nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar përfaqësuar nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mbrojtjes në zbatimin e reformave në proceset e tij të prokurimit për të siguruar ofrim të mirë-menaxhuar dhe efikas të shërbimeve publike.

Gjithashtu ky memorandum ka për qëllim rritjen e efikasitetit të sektorit publik dhe rivendosjes së besimit të qytetarëve përmes proceseve të mirë-menaxhuara, transparente, të drejta dhe efikase të prokurimit. Memorandumi i nënshkruar është një ndër marrëveshjet e shumta me Mbretërinë e Bashkuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në kuadër të partneritetit të fuqishëm me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.

Ministri Mehaj priti ambasadoren e Holandës znj. Lobbezoo

Në vazhden e takimeve me përfaqësuesit diplomatikë të vendeve mike në Kosovë, ministri i Mbrojtjes, z. Armend Mehaj priti në takim, ambasadoren e Holandës në Kosovë, znj. Carin Lobbezoo. Me këtë rast, ambasadorja Lobbezoo e uroi ministrin Mehaj për detyrën dhe i dëshiroi suksese në punën e tij duke theksuar interesimin e Qeverisë së Holandës që bashkëpunimi në mes dy vendeve edhe në fushën e mbrojtjes të vazhdojë me intensitet të shtuar drejt avancimit të mëtejme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij, ministri Mehaj e falënderoi ambasado-



ren Lobbezoo për mbështetjen e qeverisë holandeze me ministrinë dhe forcat e saj ushtarake për arritjet e deritanishme dhe theksoi nevojën për zgjerimin e

bashkëpunimit në përputhje me interesat e përbashkëta të dy ministrive dhe ndikimit të tyre në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

ARMEND MEHAJ PRITI AMBASADORËT HRISTO GUDJEV DHE SHPRESA JUSUFI

Bashkëpunim në mbrojtje me Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut

Ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj priti në takime të ndara, ambasadorin bullgar në Prishtinë, zotin Hristo Gudjev dhe ambasadoren e Maqedonisë së Veriut në Kosovë, znj. Shpresa Jusufi.

Me këtë rast, ambasadori bullgar Gudjev, përveç urimeve për detyrën e ministrit, theksoi edhe mbështetjen e shtetit të Bullgarisë si anëtare e NATO-s, në funksion të realizimit të synimeve për integritet euroatlantike dhe iniciativat rajonale dhe organizatat të tjera ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes. Nga ana e tij, ministri Mehaj e njoftoi me prioritetet e tij si dhe vlerësoi përkrahjen e shtetit mik bullgar për Kosovën, Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së. Në fund, të dy u pajtuan se është i nevojshëm forcimi i mëtejme i bashkëpunimit në mes të dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në interes të përbashkët dhe në interes



të stabilitetit, paqes dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Edhe ambasadorja e Maqedonisë së Veriut në Kosovë, znj. Shpresa Jusufi e uroi ministrin Mehaj për detyrën duke theksuar rëndësinë e thellimit të mëtejme të bashkëpunimit bilateral në fushën e sig-

urisë dhe mbrojtjes. Nga ana e tij, Ministri Mehaj, vlerësoi nivelin e bashkëpunimit të deritanishëm duke shprehur interesimin për intensifikimin e bashkëpunimit dhe koordinimit si dy vende fqinje për qështjet me interes të përbashkët në fushën e mbrojtjes.

Ministria Shekerinska në Bratislavë, Sllovaki

Maqedonia e Veriut-Sllovaki: Mbështetje reciproke për aftësinë mbrojtëse

Maqedonia e Veriut dhe Sllovakia besojnë fuqimisht se uniteti i NATO-s sjell zhvillimin e aftësive të mbrojtjes dhe një angazhim të fortë për mbrojtjen kolektive

Janë hedhur bazat për intensifikimin e bashkëpunimit të mbrojtjes midis dy vendeve aleate të NATO-s, Maqedonisë së Veriut dhe Sllovakisë, i cili do të zhvillojë kapacitetet kombëtare dhe ato të Aleancës për Mbrojtjen Kolektive. Anëtarësimi i plotë i Maqedonisë së Veriut në Aleancë ka forcuar sigurinë rajonale dhe tani është e nevojshme të bëhet hapi i shumëpritur dhe i merituar përpara në integrimin europian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky është përfundimi i takimit më 17 qershor 2021, në Bratislavë me Ministren e mbrojtjes Radmila Shekerinska dhe homologun e saj Sllovak, Jaroslav Nad.

Ministria Shekerinska theksoi se anëtarësimi i vendit në Aleancë është një përfitim për sigurinë e të gjithë rajonit. Ajo tha se fillimi i procesit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Union do të forcojë vlerat europiane dhe do të lejojë që vendi dhe rajoni të vazhdojnë të zhvillohen në përputhje me vlerat europiane, dhe në të njëjtën kohë t'i japë fund përpjekjeve për ndikime të tjera jo-europiane.

Ministri Nad shprehu mbështetje të hapur dhe të qartë për fillimin e negociatave të pranimit për Maqedoninë e Veriut, duke treguar se vendi ka përmbushur atë që ka premtuar dhe se një vendim pozitiv i Bashkimit Europian do të konfirmojë besueshmërinë e procesit të pranimit.

Në kontekstin e bashkëpunimit të mbrojtjes, Ministrat Shekerinska dhe Nad theksuan hapjen e të dy vendeve për intensifikimin e tij, duke pasur parasysh që të dy si Maqedonia e Veriut dhe Sllovakia besojnë fuqimisht se uniteti i NATO-s, mbështetja e ndërsjellë në zhvillimin e aftësive të mbrojtjes dhe një angazhim i fortë për mbrojtjen kolektive janë themelet për të ruajtur sigurinë dhe prosperitetin në zonën euro-atlantike.



Komandanti i Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën, gjeneral Christopher Cavoli, gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Maqedonisë Veriore, bëri një vizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore.

Pas pritjes në Ministri dhe Shtabin e Përgjithshëm, Gjenerali Cavoli pati takime të ndara me Ministren e Mbrojtjes Radmila Shekerinska dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Lejtnant Vasko Gjurginovski, në të cilën morën pjesë Ambasadorja e SHBA-së, Kate Mary Burns, dhe një pjesë përfaqësuese e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë. Në takimin me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe disa nga gjeneralët e ushtrisë, gjeneralit Cavoli iu prezantuan aktivitetet në lidhje me procesin e integritetit të Maqedonisë së Veriut të plotë në NATO, angazhimin në operacionet paqeruajtëse të drejtuara nga NATO, por edhe angazhimin e ushtrisë në trajtimin e krizës së migrantëve dhe ndihma ndaj institucioneve në trajtimin e "Covid 19", si dhe përgatitja për aftësinë e plotë operacionale të përbërjes sonë më të madhe të deklaruar, grupit të batalionit të këmbësorisë së lehtë.

Në këtë kontekst, bëhej fjalë për forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe pjesëmarrjen në aktivitetet aktuale të stërvitjes të udhëhequr nga Komanda e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën, përfshirë stërvitjen "Strike Struktive 21", si pjesë e "Defender Europe 21" dhe aktivitetet e përbashkëta inxhinierike të AP "Krivolak" i cili përmirësoi kapacitetet e terrenit të trajnimit për kryerjen e aktiviteteve të mëdha stërvitore. Gjenerali Cavoli vlerësoi përparimin intensiv integruar të zbatuar nga Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore pas anëtarësimit të plotë në NATO, duke theksuar se kjo është rezultat i përgatitjes dhe angazhimit të

Zhvillohet stërvitja "Goditje e Vendosur 21"

Në "Krivollak", në prani të udhëheqjes më të lartë politiko-ushtarake të Maqedonisë së Veriut dhe mysafirëve të shquar nga SHBA dhe aleatët, u realizua Dita për Mysafirë të Shquar të stërvitjes "Goditja e Vendosur 21", ku u prezantua zhvillimi i operacionit dhe aktivitetet ofanzive të këmbësorisë dhe njësisve speciale të Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut, SHBA, Greqisë dhe Bullgarisë, me mbështetjen e helikopterëve VING dhe avionëve F-16 nga forcat e armatosura greke. Në prani të presidentit Stevo Pendarovski, kryetarit të kuvendit Talat Xhaferi, kryeministrit Zoran Zaev dhe mysafirëve të tjerë të shquar, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska tha se fuqia e NATO-s është në unitetin e saj dhe se kjo stërvitje tregoi unitet, aleancë, gatishmëri dhe bashkëpunim që mund ta ketë vetëm Aleanca më e fuqishme ushtarako-politike që e njeh bota.

„Stërvitja Goditje e Vendosur 21 tregon që anëtarësimi në NATO nuk është në të vërtetë vetëm një arritje formale që do ta shkruajmë dhe do



të themi se është arritja e qëllimit tonë strategjik. Anëtarësimi në NATO është një punë e përditshme praktike, stërvitje dhe luftim i përbashkët, punë në terren që legjitimon Armatën e Maqedonisë së Veriut si të barabartë, të harmonizuar, të njëjtë me Ushtritë Aleate", tha ministrja. Shekerinska tha se dy javët e kaluara, "këmbësoria dhe njësitë speciale të ushtrive të Maqedonisë së Veriut, SHBA-së, Greqisë dhe Bullgarisë kanë treguar se ata veprojnë si një, se ata janë fuqia e NATO-s, se ushtari maqedonas në veprim mund t'ia besojë jetën e tij amerikanit, bullgarit dhe grekut, ose për të mbrojtur jetën e secilit prej

homologëve të tij aleatë ndërsa po zhvillohet aksioni."

Gjeneral Brigade Xhed Shaertel, zëvendës komandant i Forcave të Armatosura të SHBA-së për Evropën dhe Afrikën, shprehu kënaqësinë për praninë në Krivollak dhe mundësinë për të parë drejtpërdrejtë, siç tha ai, mundësinë mbresëlënëse për trajnim të vërtetë në këtë poligon. Stërvitja „Goditje e Vendosur 21" në poligonin "Krivollak" është pjesë e stërvitjes më të madhe të NATO-s "Defender Europe 21" që po zhvillohet në Evropë këtë vit. "Goditja e Vendosur 21" përfshin 1,500 pjesëtarë të forcave të armatosura nga 4 shtete anëtare të NATO-s-Maqedonia e Veriut, SHBA, Greqia dhe Bullgaria. Stërvitja filloi më 17 maj dhe ka zgjatur deri më 2 qershor. Qëllimi i stërvitjes ishte të demonstrojë një nivel të lartë të ndërveprimit, gatishmërisë luftarake dhe stërvitjes së Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë me ushtritë Aleate si dhe forcimin e bashkëpunimit të forcave aleate konvencionale dhe speciale.

GJENERAL CHRISTOPHER CAVOLI

Po zhvillohet stërvitja "Strike Struktive 21", pjesë e "Defender Europe 21"

shkëlqyeshëm të mëparshëm për anëtarësimin në NATO. Në takim, gjenerali Gjurginovski shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të Forcave të Armatosura të SHBA-së, përmes së cilës, duke kryer stërvitje dhe stërvitje të përbashkët të udhëhequr nga kjo komandë, njësitë dhe anëtarët tanë forcan aftësitë e tyre dhe arritën ndërveprimin sipas standardeve të NATO-s. Ai theksoi se në të ardhmen, përveç pajisjes dhe trajnimit, Shtabi i Përgjithshëm do t'i kushtojë vëmendje të veçantë menaxhimit të personelit, i cili do të mundësojë ndërveprim të plotë në komandimin dhe ekzekutimin e procedurave dhe procedurave të NATO-s. Në takimin me Ministrin Sekerinska, Gjenerali u informua se integrimi ushtarak i Maqedonisë Veriore në NATO po vazhdon sipas planit dhe pritët të përfundojë deri në fund të këtij viti. Ajo falënderoi për angazhimin e njësisë inxhinierike të Ushtrisë Amerikane në përgatitjen e poligonit Krivolak për stërvitjen "Goditje Vendimtare 21" që aktualisht po zhvillohet në poligon. Zhvillimi i Krivolak është një qëllim i përbashkët, mbi të

cilin Ushtria e Maqedonisë Veriore dhe Ushtria e SHBA-së po punojnë si aleatë - tha Ministri.

Anëtarësimi i Maqedonisë Veriore në NATO dhe hapja e negociatave me Bashkimin Europian janë thelbësore për sigurinë dhe stabilitetin në rajon-u tha në takim. Takimi u përqëndrua në rëndësinë e zhvillimit të bashkëpunimit rajonal midis Aleatëve dhe nevojën për të zgjidhur mosmarrëveshjet brenda familjes Euro-Atlantike sa më shpejt të jetë e mundur si pjesë e një angazhimi për sigurinë e përbashkët. Aktivitete të rëndësishme nga bashkëpunimi i përbashkët i pasur në aktivitetet e trajnimit këtë vit janë ushtrimi "Greva Vendimtare 21", si dhe "Trojan Footprint 21" i mëparshëm, por edhe aktivitetet e përbashkëta inxhinierike si pjesë e stërvitjes së madhe në territorin e Europës "Defender Europe 21" e udhëhequr nga Ushtria Amerikane, e krijuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë midis Shteteve të Bashkuara dhe ushtrive aleate me një fokus në ndërtimin e gatishmërisë operacionale dhe ndërveprimit me aleatët e NATO-s.

Transparencë do të thotë të jesh e hapur për interesat qytetarëve

Armata gjatë një viti e gjysmë ka treguar se ajo është gjithmonë në shërbim të qytetarëve të saj, për mirë apo për keq, dhe ky është një hap tjetër pozitiv

“Pas vetëm tre vjetësh nga një prej institucioneve më të mbyllura në vend, ne jemi bërë kampion në transparencë, me 100 pikë ose 100 përqind, sipas analizës së transparencës aktive të organizatave joqeveritare që kanë analizuar institucionet për vite. “Është një kompliment dhe njohje e madhe e shumë njerëzve në Ministrinë e Mbrojtjes, për mua personalisht, por edhe për Qeverinë e cila ka vendosur politikën e transparencës në një nivel të lartë-si një nga përparësitë e saj”, tha ministria Radmilla Shekerinska gjatë vizitës së saj në Shtëpinë e Armatës.

Mirëpo politika e transparencës, tha Shekerinska, duhet të nënkuptojë gjithashtu happe për interesat e qytetarëve. “Ne hapim Shtëpinë e Armatës për të gjithë qytetarët, bashkëpunimi me Katedrën e Vallëzimit Modern është shembulli më i suksesshëm i kësaj,” tha ajo.

„Armata gjatë një viti e gjysmë ka treguar se ajo është gjithmonë në shërbim të qytetarëve të saj, për mirë apo për keq, dhe ky është një hap tjetër në atë drejtim. Vendet e vogla me burime modeste duhet të jenë racionale dhe se racionaliteti do të thotë që ne duhet të bashkëpunojmë më shumë. “Si qeveri, ne besojmë se kultura dhe arti do të na ndihmojnë në shërimin e dhimbjes, shërimin e plagëve të pandemisë, sepse kemi parë sa e kushtueshme është të kesh lirinë për të dalë, për të parë njëri-tjetrin pa maska, sa



shtrenjtë kushton mundësia për t'u kthyer në aktivitetet e rregullta” theksoi ministria në evenimentin ku gjithashtu i pranishëm ishte ambasadori hollandez Dirck Jan Kopp, ambasada e të cilit mbështeti financiarisht rregullimin e ambienteve, dekanja e Fakultetit të Arteve të Filmit, në përbërje të së cilit ndodhet studioja e vallëzimit modern “Risima Risimkin”, dhe prorektorët e universitetit, Dejan Mirakovski dhe Mishko Xhidrov.

Ajo shtoi se kultura është mbrojtja më e mirë e çdo kombi, nga shija e keqe, nga manipulimet, nga nacionalizmi, gjë që është arsyeja për të ndërtuar partneritete të tilla në të ardhmen. Për bashkëpunimin me Universitetin në Shtip, ministria tha se është intensiv dhe se do të vazhdojë

të zhvillohet.

„Dy vjet më parë morëm ndihmë fisnike nga Universiteti i Shtipit, i cili pa asnjë kompensim na siguroi një matje të plotë të të gjitha të dhënave në lidhje me mjedisin e ‘Krivollak’, për të gjitha stërvitjet e mëdha që bëme. “Ky është një shans i vogël për ne që të kthehemi drejt universitetit,” përfundoi Shekerinska. Ministria e Mbrojtjes, e udhëhequr nga parimet e hapjes dhe kujdesit për interesat e qytetarëve, vuri një pjesë të kapaciteteve të Shtëpisë së Armatës në dispozicion të Asociacionit të Veteranëve, shoqatave të gjeneralëve dhe pensionistëve ushtarakë, dhe tani për Katedrën e Vallëzimit Modern pranë universitetit “Goce Delçev” nga Shtipi.

Samiti i NATO-s më 14 qershor 2021

Stoltenberg: NATO po hap një kapitull të ri

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Duke mbërritur në Samitin e NATO-s më 14 qershor 2021, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se takimi do të ishte një moment kryesor për Aleancën dhe një kohë për të "hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike". Stoltenberg përcaktoi një agjendë të plotë për takimin, duke përfshirë marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë, që janë "në pikën e tyre më të ulët që nga Lufta e Ftohtë për shkak të modelit të sjelljes agresive të Rusisë", si dhe Kina, e cila ofron mundësi por "gjithashtu paraqet disa sfida për sigurinë tonë". Në këtë sfond, Sekretari i Përgjithshëm tha se udhëheqësit e 30 vendeve të Aleancës do të binin dakord për një agjendë ambicioze të NATO-s 2030, në një botë më konkurruese, e cila përfshin përforcimin e mbrojtjes kolektive, forcimin e rezistencës, mpohjen e avantazhit teknologjik dhe bërjen e klimës dhe sigurisë një detyrë të rëndësishme për Aleancën, si dhe "për të mbajtur shpenzimet e mbrojtjes lart, dhe për të investuar më shumë së bashku, për të përmbyshur nivelin e lartë të ambicies". Jens Stoltenberg, nuk la pa përmendur edhe dakordësinë për të zhvilluar Konceptin Strategjik të ardhshëm të NATO-s për Samitin në 2022.

Por ndërkohë sfondi i Samitit të 14 qershorit u kompletua gjithashtu me Monumentet e Brukselit që



u veshën me blunë e NATO-s dhe qëndruan ashtu deri më 15 qershor 2021. Flamujt e NATO-s u valëvitën nën Harkun Cinquantenaire në Bruksel nga 11 deri në 15 qershor dhe në hyrje të Atomiumit në 14 qershor, si dhe Bashkia e Brukselit në Grand Place e listuar nga UNESCO, u ndriçua me blunë e NATO-s natën e 13 qershorit. Kurse Shatërvani në mes të rrethrotullimit Montgomery, (marë emrin nga Field Marshal Montgomery, Zëvendës Komandanti i parë i Përgjithshëm i Aleancës i NATO-s), u ndiçua gjithashtu me ngjyrën blu të NATO-s nga 11 deri në 15 qershor.

Samiti, një moment i rëndësishëm për Aleancën

Samiti i NATO-s në Bruksel i filloi punimet të hënën më 14 qershor 2021 dhe i përfundoi po atë ditë. Udhëheqësit e vendeve të NATO-s morën vendime të rëndësishme për të hartuar kursin e Aleancës gjatë

dekadës tjetër dhe më gjerë. Ata riafirmuan qasjen me mbrojtje të dyfishtë të Aleancës për mbrojtjen dhe dialogun ndaj Rusisë. Ata u zotuan gjithashtu të vazhdojnë të mbështesin partnerët e NATO-s Ukrainën dhe Gjeorgjinë, duke i sjellë ata më pranë Aleancës. I bënë thirrje Kinës që të mbështesë angazhimet e saj ndërkombëtare dhe të veprojë me përgjegjësi në sistemin ndërkombëtar. Ata ranë dakord mbi nevojën për të adresuar sfidat e paraqitura nga rritja e ndikimit të Kinës dhe politikave ndërkombëtare dhe për t'u angazhuar me Kinën për të mbrojtur interesat e sigurisë së NATO-s. Aleatët ranë dakord për një agjendë ambicioze të NATO-s 2030 për të siguruar që Aleanca mund të përballë me sfidat e sotme dhe të nesërme. Ata morën vendime për të forcuar konsultimet politike, për të forcuar mbrojtjen kolektive, për të forcuar qëndrueshmërinë, për të mpohur avantazhin teknologjik të

NATO-s, për të mbështetur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, për të rritur trainimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për partnerët dhe për të adresuar ndikimin e sigurisë së ndryshimit të klimës. Ata ranë dakord për të zhvilluar Konceptin Strategjik të ardhshëm të NATO-s për samitin në 2022. "Për të bërë më shumë, aleatët ranë dakord që ne duhet të investojmë më shumë së bashku në NATO," tha Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg. Ai vuri në dukje se kjo do të kërkojë burime të rritura në të tre buxhetet e NATO-s, ushtarake, civile dhe infrastruktura. Udhëheqësit e NATO-s gjithashtu ranë dakord për një politikë të re të mbrojtjes kibernetike për NATO-n dhe bënë të qartë se Aleanca është e vendosur të mbrojë veten në hapësirë në mënyrë efektive si në fushat e tjera ushtarake. Për Afganistanin, ata riafirmuan angazhimin e tyre për të qëndruar pranë Afganistanit me trajnim dhe mbështetje financiare për forcat dhe institucionet afgane dhe fonde për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të aeroportit ndërkombëtar. "Ne kemi marrë vendime të rëndësishme sot për ta bërë NATO më të fortë në një botë më konkurruese", theksoi Sekretari i Përgjithshëm.

Rusia dhe Kina sfidojnë rendin e bazuar në rregulla

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, në një konferencë për shtyp njoftoi gjithçka pas takimit të shefave të Shteteve dhe Qeverive të NATO-s, dhe dha një pasqyrë të qartë të asaj që kishte ndodhur në Samit. "Sapo kemi përfunduar një takim shumë të mirë, Samitin e NATO-s. Ishte vërtet e mrekullueshme të ishim së bashku dhe të takoheshim përsëri bashkë personalisht, si një familje me të vërtetë transatlantike, ose siç tha Kryeministri Johnson, ishte si dita e parë që kthehesh në shkollë, duke parë përsëri të gjithë miqtë e tu të vjetër", tha ai duke përshkruar atmosferën në sallë. "Sot, ne hapim një kapitull të ri për Aleancën tonë. Ne adresuam çështje kryesore për sigurinë tonë dhe morëm vendime të gjera. Kemi dëgjuar një mesazh të fortë nga Presidenti Biden për

angazhimin e Amerikës ndaj NATO-s dhe një angazhim po aq të fortë nga aleatët e tjerë në kthim. Të gjithë udhëheqësit ranë dakord që, në një epokë të konkurrencës globale, Evropa dhe Amerika e Veriut duhet të qëndrojnë të fortë së bashku në NATO. Të mbrojmë vlerat dhe interesat tona. Sidomos në një kohë kur regjimet autoritare si Rusia dhe Kina sfidojnë rendin e bazuar në rregulla. Aleatët mirëpritën konsultat e sotme me Presidentin Biden, përpara takimit të tij me Presidentin Putin në Gjenevë", iu tha Sekretari i Përgjithshëm medieve. "Marrëdhënia jonë me Rusinë është në pikën më të ulët që nga Lufta e Ftohtë dhe veprimet agresive të Moskës janë një kërcënim për sigurinë tonë", por "NATO mbetet e përkushtuar në qasjen tonë të dyfishtë të mbrojtjes dhe dialogut", nënvizoi ai. "Ne do t'i mbajmë mbrojtjet tona të forta, ndërsa do të qëndrojmë të gatshëm për të biseduar, për t'i bërë të qarta pozicionet tona, shmangim keqkuptimin dhe parandalojmë përshkallëzimin. Ne e mbështesim plotësisht vendimin për zgjatjen e Traktatit të Ri START dhe ne do të mirëpresim bisedime të reja strategjike për kontrollin e ardhshëm të armëve, me koordinim të vazhdueshëm këtu në NATO". Por "ne qëndrojmë në solidaritet me partnerët tanë të vlerësuar Ukraina dhe Gjeorgjia dhe ne do të vazhdojmë të mbështesim reformat e tyre, duke i sjellë ata më afër NATO-s", tha Sekretari i Përgjithshëm për partnerët e Aleancës duke u ndalur më tej për Kinën dhe sfidat e saj. "Në Samitin e sotëm, ne gjithashtu iu drejtuan Kinës. Ekziston një konvergencë e fortë e pikëpamjeve midis aleatëve. Bazuar në interesat tona, ne shohim mundësi për t'u angazhuar në çështje të tilla si kontrolli i armëve dhe ndryshimi i klimës. Por ndikimi në rritje i Kinës dhe politikat ndërkombëtare paraqesin sfida për sigurinë e Aleancës. Udhëheqësit ranë dakord që ne duhet të adresojmë sfida të tilla së bashku si një Aleancë dhe se duhet të angazhohemi me Kinën për të mbrojtur interesat tona të sigurisë. Ne jemi të shqetësuar nga politikat shtrënguese të Kinës të cilat qëndrojnë në kontrast me vlerat

themelore të ngulitura në Traktatin e Uashingtonit". Kina po zgjeron me shpejtësi arsenalin e saj bërthamor me më shumë koka luftarake dhe një numër më të madh të sistemeve të sofistikuara të shpërndarjes. "Eshtë e paqartë në zbatimin e modernizimit të saj ushtarak. Ajo po bashkëpunon ushtarakisht me Rusinë, përfshirë përmes stërvitjeve në zonën Euro-Atlantike. Ne gjithashtu mbetemi të shqetësuar për përdorimin e dezinformimit nga Kina. Udhëheqësit e NATO-s i bënë thirrje Kinës të mbështesë angazhimet e saj ndërkombëtare dhe të veprojë me përgjegjësi në sistemin ndërkombëtar. Përfshirë në hapësirë, fushat kibernetike dhe detare, në përputhje me rolin e saj si një fuqi e madhe", tha ai.

Kursi i Aleancës së NATO-s për dekadën ardhshme dhe më gjërë

"Sot, udhëheqësit ranë dakord për agjendën tonë ambicioze të NATO-s 2030. Për të siguruar që Aleanca mund të përballet me sfidat dhe kërcënimet e sotme dhe të nesërme. Ne morëm vendime konkrete në tetë fusha kryesore. Së pari, ne ramë dakord të rrisim NATO-n si forumin transatlantik për konsultime dhe veprime të përbashkëta për të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë tonë. Ne ramë dakord për të forcuar dhe zgjeruar konsultimin dhe koordinimin tonë politik. Së dyti, ne ranë dakord të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë, duke forcuar NATO-n si kornizë për mbrojtjen e zonës Euro-Atlantike dhe ripranimi në Betimin e Investimeve të Mbrojtjes që bëmë në 2014. Së treti, kemi rënë dakord të forcojmë qëndrueshmërinë e shoqërive tona. Me një angazhim të ri të qëndrueshmërisë nga udhëheqësit e NATO-s. Ne do të zhvillojmë objektiva të qëndrueshmërisë në të gjithë NATO-n dhe qëllime konkrete kombëtare, për të mbrojtur infrastrukturën tonë kritike. Së katërti, ne do të mprehim avantazhin tonë teknologjik. Aleatët kanë rënë dakord të fillojnë një Përsheptues të Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut, ose DIANA. Duke punuar me fillestarët, industrinë dhe

universitetet, kjo qendër do të promovojë bashkëpunimin transatlantik dhe do të ndihmojë në shmangien e boshllëqeve midis Aleatëve. Aleatët kanë gjithashtu dakord të krijojnë një Fond të Inovacionit të NATO-s, për të investuar në fillestarët që punojnë në teknologjitë e reja dhe përçarëse. Së pesti, ne do të rritim punën tonë për të mbështetur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Për këtë qëllim, ne do të forcojmë partneritetin tonë në Azi-Paqësor, me Australinë, Japoninë, Zelandën e Re dhe Republikën e Koresë dhe do të kërkojmë marrëdhënie të reja me vendet në të gjithë Amerikën Latine, Afrikën dhe Azinë. Ne jemi të përkushtuar gjithashtu për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë me Bashkimin Evropian. Së gjashti, ne do të rritim në mënyrë thelbësore trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për partnerët, nga Ukraina dhe Gjeorgjia në Irak dhe Jordani. Së shtati, udhëheqësit kanë dakord që për herë të parë, adresimi i ndikimit të sigurisë së ndryshimit të klimës do të jetë një detyrë e rëndësishme për NATO-n. Kjo do të përfshijë vlerësime të rregullta të ndikimit të ndryshimit të klimës në instalimet tona, misionet dhe aktivitetet e tjera. Integrimi i ndryshimit të klimës në ushtrimet tona, planifikimin e mbrojtjes dhe prokurimin tonë dhe zhvillimin e një metodologjie për vlerësimin e emisioneve të gazrave serë nga aktivitetet ushtarake. Jam i kënaqur të njoftoj se të gjithë Aleatët bënë një angazhim të qartë për të ulur ndjeshëm emetimet ushtarake. Ne gjithashtu ramë dakord për të vendosur objektiva konkrete për NATO-n për të kontribuar në qëllimin e emetimeve Neto Zero deri në vitin 2050. Unë gjithashtu dua të falënderoj Kryeministrin Justin Trudeau dhe Kanadanë për ofrimin për të pritur një Qendër të re të NATO-s të Ekselencës për Klimën dhe Sigurinë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, duke njoftuar gjithashtu edhe mbi nevojën e zhvillimit të një Koncepti Strategjik të NATO-s. "Më në fund, ne ramë dakord të zhvillonim Konceptin Strategjik të ardhshëm të NATO-s në kohën e samitit tonë në 2022. Riafirmimi i vlerave tona dhe pasqyrimi i ndryshi-

meve të rëndësishme në mjedisin tonë të sigurisë gjatë dekadës së fundit. Agjenda e NATO-s 2030 përcakton një nivel më të lartë të ambicies dhe siguron një drejtim të qartë për adaptimin e ardhshëm të Aleancës sonë. Aleatët kanë dakord që këto vendime duhet të mbështeten nga burimet e duhura, përmes shpenzimeve të mbrojtjes kombëtare dhe fondeve të përbashkëta të NATO-s. Ky do të jetë viti i shtatë radhazi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë Aleatët Evropianë dhe në Kanada. Me mbi 260 miliardë dollarë amerikanë shtesë në mbrojtje që nga viti 2014". Aleatët gjithashtu po investojnë në aftësi të reja edhe duke kontribuar në misionet dhe operacionet e NATO-s. "E gjithë kjo do të thotë ndarje më e drejtë e barrës në të gjithë Aleancën dhe ne duhet ta mbajmë këtë moment", theksoi Stoltenberg. Për të bërë më shumë së bashku, aleatët kanë dakord që gjithashtu duhet të investojnë më shumë së bashku në NATO, për të buruar kërkesat tona në një mjedis më sfidues i sigurisë. Kjo do të kërkojë burime të rritura në të tre buxhetet e NATO-s: ushtarake, civile dhe infrastrukturë. Për shembull, për të mbështetur më shumë trajnime dhe ushtrime të përbashkëta, komandimi dhe kontrolli, mbrojtje më të fortë kibernetike, pajisje të para-pozicionuara, infrastrukturë më e mirë, dhe më shumë ndërtim të kapaciteteve për partnerët tanë. Pra, duke rënë dakord për axhendën e NATO-s 2030, udhëheqësit kanë marrë vendime për ta bërë Aleancën tonë më të fortë dhe më të përshtatshme për të ardhmen. Ne gjithashtu morëm vendime për fushat tona më të reja operacionale: kibernetika dhe hapësira. Aleatët kanë dakord për një politikë të re të mbrojtjes kibernetike për NATO-n. Ajo pranon që hapësira kibernetike kontestohet në çdo kohë dhe siguron që ne kemi aftësitë teknike të fortë, konsultime politike, dhe planifikimin ushtarak në vend për të mbajtur sistemet tona të sigurta. Ne gjithashtu e bëmë të qartë se NATO është e vendosur të mbrojë veten në hapësirë po aq efektive sa ne në të gjitha fushat e tjera: toka, deti, ajri dhe kiberneti dhe unë falënderoj Luksemburgun për financimin e një

Sistemi Strategjik të Ndërgjegjësimit të Situatës Hapësinore këtu në Selinë e NATO-s. Ne gjithashtu iu drejtuam Afganistanit. Pas gati 20 vjetësh, operacionet ushtarake të NATO-s po marrin fund. Ne u bëjmë nderime të gjithë atyre që kanë humbur jetën ose janë plagosur dhe shprehim vlerësimin tonë për të gjithë ata që kanë shërbyer nën flamurin e NATO-s. Udhëheqësit e NATO-s riafirmuan angazhimin e tyre për të vazhduar të qëndrojnë me Afganistanin, me trajnim dhe mbështetje financiare për forcat dhe institucionet afgane dhe fonde për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të aeroportit ndërkombëtar. Kështu që ne kemi marrë vendime të rëndësishme sot. Për ta bërë NATO-n më të fortë në një botë më konkurruese dhe përshkruajmë kursin për Aleancën tonë gjatë dekadës së ardhshme dhe më gjërë".

Samiti i ardhshëm i NATO-s do të mbahet në Spanjë

Ndërsa Samiti i NATO-s i qershorit 2021 uli siparin, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s njoftoi samitin tjetër të radhës me një falënderim për kryeministrin spanjoll Pedro Sanchez për ofertën për të pritur Samitin e NATO-s 2022 në Spanjë. "Është një mundësi e shkëlqyer për të shënuar dyzet vjetorin e anëtarësimit tuaj", tha Sekretari i Përgjithshëm. "Në samitin tonë në Spanjë vitin e ardhshëm, udhëheqësit e NATO-s do të marrin vendime të rëndësishme për të ardhmen e Aleancës sonë", tha ai, si "një mundësi e shkëlqyeshme" për Spanjën, "që është një aleat kaq i vendosur dhe i përkushtuar për 40 vjet". Spanja kontribuon në sigurinë e përbashkët në mënyra të ndryshme, si në grupin e betejës në Letoni, në policimin ajror në rajonin Baltik, pret anijet e mbrojtjes nga raketat balistike Aegis në Rota, dhe trupat e saj kanë shërbyer në Afganistan, si dhe ka një "rol kyq" në misionin trajnues të NATO-s në Irak. "Në Samitin tonë në Spanjë, vitin e ardhshëm, ne do të pajtohemi me konceptin tjetër strategjik të NATO-s, i cili më pas do të jetë Koncepti Strategjik i Madridit", një dokument tjetër i rëndësishëm për NATO-n.

Operacioni ushtarak “Barbarosa”, 22 qershor 1941

Realizimi i planit “Barbarosa” u mbështet në teorinë e luftës “totale” dhe “rrufe”, si dhe mbi përvojën që kishte fituar ushtria gjermane në operacionet në Europë gjatë viteve 1939-1940

PROF.ASOC.DR.BERNARD ZOTAJ

Përgatitja e planit të mashtrimit

Gjermania naziste në dy vitet e para të Luftës së Dytë Botërore po arrinte rezultate politike dhe ushtarake në Europë. Në këto vite kishte pushtuar tetë shtete europiane dhe së bashku me Italinë fashiste, të rreshtuar përkrah saj, pushtoi dhe Greqinë. Ajo bëri aleatë Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë dhe Finlandën. Objektivat strategjike i arriti shkallë shkallë, në qetësi dhe të llogaritura për realizimin e strategjisë së saj, agresionin kundër Bashkimit Sovjetik (BS). Me pushtimin e Polonisë krijoi kryeurën kundër BS në qendër, me pushtimin e Norvegjisë në veri dhe me Ballkanin dhe mësymjen në jug të Europës. Europa Perëndimore i siguronte kushte të përshtatshme në prapavijë.

Dështimi për të mos siguruar aleancën me Anglinë dhe disfata ajrore me të, bënë që të bjerë barriera e parë e fuqishme ushtarake e Vermahtit. Me pushtimin e BS, Gjermania naziste synonte të shkatërronte sistemin komunist, të shtinte në dorë rezervat materiale të tij, të rriste fuqinë ushtarake dhe ekonomike për realizimin e strategjisë për sundimin botëror. Në kushtet e përgatitjes për agresion arriti befasinë e goditjes. Kjo në sajë



të besueshmërisë në seriozitetin e paktit Ribentrop-Molotov.

Pakti Ribentrop-Molotov bëri që BS të fitojë kohë në përgatitjen e vendit, forcimin e ushtrisë dhe pajisjen e saj me teknikë luftarake. Pakti solli veçimin e BS nga vendet perëndimore. BS u tregua indiferent ndaj Ballkanit. Përgatitja dhe zbatimi nga komanda gjermane i planit të mashtrimit, gjeti terren të përshtatshëm agresionin nazist ndaj BS. Në muajt e parë të vitit 1941 mashtrimi pati lëvizjen e mjaft divizioneve të ushtrisë gjermane në Ballkan. Në muajt prill-qershor 1941, lëvizjet e forcave nga Ballkani dhe përqëndrimi në frontin lindor, dhanë sinjalin për agresion.

Organizimi dhe përgatitja e planit të mashtrimit u ideua në direktivën për dizinformimin e armikut. Feldmaresiali Keitel, Shef i Shtabit të Komandës Supreme përpunoi udhëz-

imet për të demaskuar përgatitjen e operacionit “Barbarosa”. Sektori i zbulimit dhe i kundërzbulimit të Shtabit të Përgjithshëm përpunuan dhe zbatuan disa aksione, si në përhapjen e fjalëve dhe të njoftimeve mashtruese. Përqëndrimi i ushtrisë gjermane në lindje dhe manovrat dizinformuese, nga më të mëdhatë në histori, kishin qëllim të tërhiqnin vëmendjen nga përgatitjet për të sulmuar Anglinë.

Mareshallët Timoshenko dhe Zhukov kërkuan nga Stalini për të thirur nën armë efektivin e rezervës të divizioneve të këmbësorisë, që të kishin mundësi ta parapërgatitnin me frymën e kërkesave bashkëkohore, kërkesë e cila nuk u pranua me mendimin se mund t’u jepte shkas gjermanëve të provokonin luftën. Ushtria gjermane vazhdonte transportimin masiv të njërive të saj drejt zonave lindore. Kështu më 1 qershor

kishte përqëndruar në kufijtë me BS deri në Detin e Zi 120 divizione, me efektiv deri në 8.5 milion njerëz, ndërsa ushtria sovjetike kishte deri në 5 milion njerëz.

Në këtë situatë kërcënuese, Timoshenko kërkon me këmbëngulje të jepnin urdhërin për ta vënë ushtrinë e qarqeve kufitare në gadishmëri luftarake dhe të hapnin skalionet e para sipas planeve të mbulimit. Përgjigja e Stalinit ishte lexoni gazetën nesër. Njoftimi i TASS-it më 14 qershor theksonte se njoftimet e përhapura nga shtypi i huaj, sidomos anglez, mbi afrimin e luftës ndërmjet BS dhe Gjermanisë nuk kanë asnjë bazë. BS dhe Gjermania respektojnë pa ndërprerje kushtet e marrëveshjes sovieto-gjermane për mosulmimin dhe se zërat për qëllimin e Gjermanisë për të prishur paktin dhe sulmuar BS ishin pa asnjë bazë.

Më 21 qershor vjen informacioni tronditës i një nënoficeri dezertor gjerman, i cili bënte me dije se ushtria gjermane po lëvizte drejt pozicioneve të sulmit që do të fillonte në mëngjesin e 22 qershorit. Përsëri qëndrimi hezitues i Stalinit, duke menduar në zgjidhjen në rrugë paqësore. Edhe një direktivë e Ministrisë të Mbrojtjes që jep udhëzime për sulmin me veprime provokuese të reparteve gjermane, qarqet kufitare nuk duhet t'u përgjigjen provokacioneve për të mos shaktuar ndërlikime. Ushtria gjermane e kishte siguruar befasinë e goditjes.

Plani "Barbarosa"

Shtabi nazist gjerman nga mesi i vitit 1940 hartoi planin për agresionin ushtarak kundër BS të quajtur plani "Barbarosa". Realizimi i planit "Barbarosa" u mbështet në teorinë e luftës "totale" dhe "rrufe", si dhe mbi përvojën që kishte fituar ushtria gjermane në operacionet në Europë gjatë viteve 1939-1940. Forcat e Armatosura gjermane përfshinë në plan dhe Forcat e Armatosura të Rumanisë dhe të Finlandës. Megjithatë në këtë periudhë Japonia, nuk donte luftë kundër BS, mbante forca të konsiderueshme në kufijtë e Mançurisë.

Qëllimi i agresionit ishte shkëputja e Rusisë aziatike. Industria e Rusisë që do të mbetej në Urale, mund të paralizohet me anën e aviacionit. Qëllimi më i rëndësishëm strategjik

ishte që, me anën e operacioneve mësymëse, përparimit të shpejtë të njësive tankiste, të asgjësoheshin forcat kryesore të ushtrisë sovjetike, të cilat, gjendeshin në brezin kufitar perëndimor. Në vazhdim plani parashikonte tërheqjen e trupave sovjetike në thellësi të vendit, duke asgjësuar dy të tretat e forcave të ushtrisë sovjetike. Forcat e tjera të mbeteshin të gozhdura në kufijtë



e Finlandës, Turqisë dhe Lindjes së Largët. Hartuesit e planit mendonin se përballë forcave gjermane do mbeteshin deri në 50 Div. Sovjetike. Objektet strategjike me rëndësi politike dhe ekonomike ishin Leningradi, Pellgu i Donecit, Moska dhe rajoni qendror industrial.

Plani parashikonte zhvillimin e mësymjes në tri drejtime strategjike, grupimi Verior, grupimi Qendror dhe grupimi Jugor. Parashikohet dhënia e goditjeve ndihmuese nga territori i Finlandës dhe nga territori i Rumanisë. Realizimin e planit për pushtimin e BS komanda gjermane e parashikoi për 3-4 muaj. Duke pasur bindje në fitore, komanda gjermane hartoi në vija të gjera dhe perspektivat e zgjerimit të mëtejshëm të agresionit si kundër sundimeve britanike në Azi dhe në rajonin e Detit Mesdhe. Por zhvillimi i ngjarjeve ushtarake zbuloi karakterin aventuror të planit "Barbarosa", për pushtimin e BS brenda një fushate të vetme.

Realizimi i planit "Barbarosa", nga gjermanët bëri që të përqendroheshin në kufi me BS, 152

Divizione prej të cilëve 19 Divizione tankiste dhe 14 Divizione të motorizuar, që ishin 70 % të FT të Gjermanisë naziste. Me gjithë forcat e shteteve aleate, sasia e përgjithshme për luftë kundër BS, përbëhej nga 190 Divizione me 3410 tanke. Forcat ushtarake ajrore për luftën kundër BS përbëheshin nga 3200 avionë (2200 gjermanë dhe 1000 të aleatëve).

Më 22 qershor 1941 forcat ishin përhapur në të gjithë kufirin sovjetik nga deti Balltik deri në Karpate. Për goditjen fillestare komanda hitleriane e ndërtoi formacionin e luftimit në një skalion strategjik. Grup-armatat e kishin ndërtimin operativ në një skalion, ndërsa grupimet tankiste e kishin të skalionuar. Me qëllim që të godiste njëkohësisht gjithë thellësinë e mbrojtjes sovjetike, komanda hitleriane kishte planëzuar dhënien e goditjeve të menjëhershme të njësive gjithëharmëse, njësive tankiste dhe forcave ajrore.

Mbrojtja sovjetike në teatrin perëndimor kishte një varg mangësish si mungesa të theksuara në teknikë luftarake sidomos në tanke e aeroplanë, mangësi në pajisjen xheniere të brezave të mbrojtjes e mungesës së brezave në thellësi, infrastrukturë të prapambetur në rrjetin e komunikacionit hekurudhor e automobilistik, dobësi në radiondërlidhje, rrjet të kufizuar të aerodromeve, mungesa në stërvitjen e ushtrisë e në përgatitjen e personelit komandues, etj.



MANOVRA ME QITJE NË DET

Zhvillohët stërvitja detare dy ditore “GRUPEX 21”

Pjesë e stërvitjes ishin tetë anije. Qitjet bregdetare u zhvilluan në ishullin e Sazanit, me armatimin e anijeve në poligonin e vetullores në pjesën perëndimore të Karaburunit

